



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.139

12 tetor

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.7083 datë 14.9.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 6249
Vendim i KM nr.609, datë 24.8.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë 6249
Vendim i KM nr.610, datë 24.8.2011	Për miratimin e shtesës nr.1 të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian, për programin kombëtar, IPA, 2007, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Parazgjerimit, komponenti I - Asistenca e tranzicionit dhe mbështetjes institucionale..... 6250
Vendim i KM nr.611, datë 31.8.2011	Për miratimin e shtesës nr.1 të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian, për programin kombëtar, IPA, 2008, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Parazgjerimit, komponenti I - Asistenca e tranzicionit dhe mbështetjes institucionale..... 6252
Vendim i KM nr.612, datë 31.8.2011	Për përcaktimin e kërkesave të hollësishme për plehrat me bazë nitrat amoni, me përmbajtje mbi 28 për qind azot 6254
Vendim i KM nr.614, datë 7.9.2011	Për miratimin e kritereve dhe të normave të trajtimit me uniformë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë 6255
Vendim i KM nr.615, datë 7.9.2011	Për kontratat e tregtimit në largësi të shërbimeve financiare për konsumatorët..... 6265
Vendim i KM nr.616, datë 7.9.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Staraveckë nr.1 dhe Staraveckë nr.2” dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... 6270

Vendim i KM nr.617, datë 7.9.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Bllicë” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë	6271
Vendim i KM nr.618, datë 7.9.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1707, datë 29.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”...	6271
Vendim i KM nr.621, datë 7.9.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Zerec 1” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë	6275
Vendim i KM nr.622, datë 7.9.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë - Elbasan (Loti I)	6275
Vendim i KM nr.623, datë 7.9.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Batra nr.1, nr.2 dhe nr.3” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	6277
Vendim i KM nr.624, datë 7.9.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Rrogozhinë, të qarkut të Tiranës	6277
Vendim i KM nr.625, datë 7.9.2011	Për disa shtesa në vendimin nr.718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar	6279
Vendim i KM nr.626, datë 7.9.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.563, datë 14.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbartimor me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbartimit”	6280
Vendim i KM nr.627, datë 31.8.2011	Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2011 - 2012	6281
Vendim i KM nr.629, datë 7.9.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Financave	6284
Vendim i KM nr.630, datë 14.9.2011	Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror	6285
Vendim i KM nr.631, datë 14.9.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z. Musa Ulqini	6285
Vendim i KM nr.632, datë 14.9.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj. Valentina Londo	6286

Vendim i KM nr.648, datë 29.9.2011	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit “Reparti i prestarisë dhe zyra”, në administrim të “NPV Ushtrisë”, sh.a., Tiranë”, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin e Tiranës.....	6286
Vendim i KM nr.652, datë 14.9.2011	Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011-2012.....	6287
Udhëzim i MASH nr.36, datë 9.9.2011	Për një ndryshim në udhëzimin nr.25, datë 20.7.2011 “Për procedurat e pranimi dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012”	6293
Vendim i ERE nr.81, datë 12.9.2011	Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Kalivac Green Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues (Hec i Kalivacit), si burim i rinovueshëm energjie	6293

DEKRET
Nr.7083, datë 14.9.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, germa “c” të Kushtetutës, si dhe të nenit 9 dhe nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, mbështetur dhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Naim Isa Berisha
2. Isuf Xhafer Berisha
3. Fatmire Salih Norja (Camaj)
4. Emrah Ridvan Ikikardeş
5. Arsim Halit Jusufi
6. Mustafa Ismet Atasoy
7. Murat Levent Mehmet Muammer Hamamcioğlu
8. Pinar Sefa Hamamcioğlu (Tinaz)
9. Beril Murat Levent Hamamcioğlu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.609, datë 24.8.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË SHËRBIMIT TË MARKIMIT DHE MONITORIMIT TË
KARBURANTEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurës ligjore për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë është Ministria e Financave.

2. Miratimin e bonusit prej 6 % të pikëve për rezultatin, teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Global Fluids International”, SA (GFI), për dhënien me koncesion të këtij shërbimi.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.610, datë 24.8.2011

PËR MIRATIMIN E SHITESËS NR.1 TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT EUROPIAN, PËR PROGRAMIN KOMBËTAR, IPA, 2007, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN E PARAZGJERIMIT, KOMPONENTI I - ASISTENCA E TRANZICIONIT DHE MBËSHTETJES INSTITUCIONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Integritetit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e shtesës nr.1 të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European, për programin kombëtar IPA, 2007, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Parazgjerimit, komponenti I — Asistenca e tranzicionit dhe mbështetjes institucionale, miratuar me vendimin nr.24, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Parazgjerimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**SHITESA NR.1 E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMISIONIT EUROPIAN NË LIDHJE ME PROGRAMIN KOMBËTAR PËR SHQIPËRINË NË
KUADRIN E KOMPONENTIT IPA - ASISTENCA E TRANZICIONIT DHE MBËSHTETJA
INSTITUCIONALE PËR VITIN 2007**

SHITESA NR.1

Për marrëveshjen e financimit në lidhje me Programin Kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA “Asistenca e tranzicionit dhe mbështetja institucionale” për vitin 2007

Siç është nënshkruar më 22 janar 2008 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Përfituesi) dhe Komisionit European (“Komisioni”, këtej e tutje referuar bashkërisht si “Palët”),

Meqë:

a) Më 20 shtator 2007, Komisioni miratoi vendimin C(2007)4295 që krijon Programin Kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e Komponentit IPA - Asistenca e Tranzicionit dhe mbështetja institucionale për vitin 2007 (Programi). Marrëveshja e Financimit u nënshkrua më 22 janar 2008, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për zbatimin e programit (Marrëveshje financimi).

b) Gjatë zbatimit të programit, u bë i nevojshëm një ndryshim në lidhje me afatin e ekzekutimit dhe afatin e disbursimit të vendimit të Komisionit të përmendur më lart;

c) Për të parandaluar një humbje domethënëse të impaktit, afati i ekzekutimit është shtyrë me vendimin zbatues të Komisionit C(2011)3116, datë 10 maj 2011 që ndryshon vendimin e Komisionit C(2007)4295, datë 20 shtator 2007, nga 22 janar 2013 në 30 qershor 2014, dhe afati i disbursimit është shtyrë nga 22 janari 2014 në 30 qershor 2015, për shkak të natyrës komplekse të zbatimit të projekteve të mëdha infrastrukturore;

d) Nënshkruhet kjo shtesë në marrëveshjen e financimit për të siguruar përputhshmërinë mes marrëveshjes dhe ndryshimit aktual të programit që është bërë me vendimin zbatues të Komisionit C(2011)3116, datë 10 maj 2011.

Palët kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Paragrafi (1) i nenit 6 të marrëveshjes së financimit ndryshohet si vijon: “Kontratat duhet të ekzekutohen deri më datë 30 qershor 2014”.

Neni 2

Paragrafi (1) i nenit 7 të marrëveshjes së financimit ndryshohet si vijon: “Disbursimi i fondeve duhet të realizohet deri më datë 30 qershor 2015”.

Neni 3

Paragrafi (1) i nenit 15 të marrëveshjes së financimit ndryshohet si vijon: “Pa cenuar paragrafin 2, kjo marrëveshje përfundon më 30 qershor 2017. Ky përfundim nuk cenon mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenin 56 të rregullores zbatuese të IPA-së.”

Neni 4

Shtojca A — Programi Kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA, Asistenca e tranzicionit dhe mbështetja institucionale për vitin 2007-i marrëveshjes së financimit, zëvendësohet me shtojcën e kësaj shtese nr.1.

Neni 5

Të gjitha termat dhe kushtet e tjera të marrëveshjes së financimit mbeten të pandryshuara.

Neni 6

Kjo shtesë nr.1 hyn në fuqi në datën më të vonshme të nënshkrimit nga palët.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, një kopje për Komisionin dhe një kopje për vendin përfitues.

Nënshkruar, për dhe në emër të
Komisionit European, nga:

Nënshkruar, për dhe në emër të Këshillit të
Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nga:

z. Pierre Mirel
Drejtor,
Drejtoria e Përgjithshme
e Zgjerimit
Datë: 10.6.2011

znj. Majlinda Bregu
Ministre e Integrimit
Datë:

VENDIM
Nr.611, datë 31.8.2011

PËR MIRATIMIN E SHITESËS NR.1 TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT EUROPIAN, PËR PROGRAMIN KOMBËTAR, IPA, 2008, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN E PARAZGJERIMIT, KOMPONENTI I - ASISTENCA E TRANZICIONIT DHE MBËSHTETJES INSTITUCIONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Integritit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e shtesës nr.1 të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European, për programin kombëtar IPA, 2008, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Parazgjerimit, komponenti I — Asistenca e tranzicionit dhe mbështetjes institucionale, miratuar me vendimin nr.248, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Parazgjerimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTESA NR.1 E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMISIONIT EUROPIAN NË LIDHJE ME PROGRAMIN KOMBËTAR PËR SHQIPËRINË NË
KUADRIN E KOMPONENTIT IPA - ASISTENCA E TRANZICIONIT DHE MBËSHTETJA
INSTITUCIONALE PËR VITIN 2008

SHTESA NR.1

Për marrëveshjen e financimit në lidhje me Programin Kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA “Asistenca e tranzicionit dhe mbështetja institucionale” për vitin 2008

Sic është nënshkruar më 9 mars 2009 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Përfituesi) dhe Komisioni European (“Komisioni”, këtej e tutje referuar bashkërisht si “Palët”),

Meqë:

a) Më 19 dhjetor 2008, Komisioni miratoi vendimin C(2008)8425 që krijon programin kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA - Asistenca e tranzicionit dhe mbështetja institucionale për vitin 2008 (Programi). Marrëveshja e financimit u nënshkrua më 9 mars 2009 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për zbatimin e Programit (“marrëveshje financimi”).

b) Gjatë zbatimit të programit, u bë i nevojshëm një ndryshim në lidhje me afatin e ekzekutimit dhe afatin e disbursimit të vendimit të Komisionit të përmendur më lart.

c) Për të parandaluar një humbje domethënëse të impaktit, afati i ekzekutimit është shtyrë me vendimin zbatues të Komisionit C(2011)3115, datë 4 maj 2011, që ndryshon vendimin e Komisionit C(2008)8425, datë 19 dhjetor 2008, nga 9 mars 2013 në 31 dhjetor 2014, dhe afati i disbursimit është shtyrë nga 9 mars 2014 në 31 dhjetor 2015, për shkak të natyrës komplekse të zbatimit të projekteve të mëdha infrastrukturore.

d) Nënshkruhet kjo shtesë në marrëveshjen e financimit për të siguruar përputhshmërinë mes marrëveshjes dhe ndryshimit aktual të programit që është bërë me vendimin zbatues të Komisionit C(2011)3115, datë 4 maj 2011.

Palët kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Paragrafi (1) i nenit 6 të marrëveshjes së financimit ndryshohet si vijon: “Kontratat duhet të ekzekutohen deri më datë 31 dhjetor 2014”.

Neni 2

Paragrafi (1) i nenit 7 të marrëveshjes së financimit ndryshohet si vijon: “Disbursimi i fondeve duhet të realizohet deri më datë 31 dhjetor 2015”.

Neni 3

Paragrafi (1) i nenit 15 të marrëveshjes së financimit ndryshohet si vijon: “Pa cenuar paragrafin 2, kjo marrëveshje përfundon më 31 dhjetor 2017. Ky përfundim nuk cenon mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenin 56 të rregullores zbatuese të IPA-së.”

Neni 4

Shtojca A — Programi kombëtar për Shqipërinë në kuadrin e komponentit IPA, Asistenca e tranzicionit dhe mbështetja institucionale për vitin 2008 - i marrëveshjes së financimit, zëvendësohet me shtojcën e kësaj shtese nr.1.

Neni 5

Të gjithë termat dhe kushtet e tjera të marrëveshjes së financimit mbeten të pandryshuara.

Neni 6

Kjo shtesë nr.1 hyn në fuqi në datën më të vonshme të nënshkrimit nga palët.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, një kopje për Komisionin dhe një kopje për vendin përfitues.

Nënshkruar, për dhe në emër të
Komisionit European, nga:
Z. Pierre Mirel
Drejtor,
Drejtoria e Përgjithshme
e Zgjerimit
Datë: 6.6.2011

Nënshkruar, për dhe në emër të Këshillit të
Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nga:
Znj. Majlinda Bregu
Ministre e Integrimit
Datë:

VENDIM
Nr.612, datë 31.8.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE TË HOLLËSISHME PËR PLEHRAT ME BAZË
NITRAT AMONI, ME PËRMBAJTJE MBI 28 PËR QIND AZOT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8 të nenit 8 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kërkesave të hollësishme, që duhet të plotësojnë plehrat me bazë nitrat amoni, me përmbajtje mbi 28 për qind në masë të azotit, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKS

**KËRKESAT E HOLLËSISHME TEKNIKE PËR PLEHRAT ME BAZË NITRAT AMONI ME
PËRMBAJTJE MBI 28 % NË MASË TË AZOTIT**

Karakteristikat dhe kufijtë e plehrave me bazë nitrat amoni me përmbajtje mbi 28 % në masë të azotit janë si më poshtë vijon:

1. Poroziteti (mbajtja e vajit)

Mbajtja e vajit nga plehrat, të cilat duhet t’u jenë nënshtruar paraprakisht dy cikleve termike me temperaturë 25-50°C, nuk duhet të tejkalojë 4 % në masë.

2. Përbërësit që ndizen

Përqindja në masë e lëndës që ndizet, e matur si karbon, nuk duhet të tejkalojë:

- 0.2 % për plehrat me përmbajtje të barabartë ose mbi 31.5 % në masë azoti; dhe

- 0.4 % për plehrat me përmbajtje të barabartë ose mbi 28 %, por më të ulët se 31.5% në masë azoti.

3. Pehashi (pH)

Pehashi (pH) në një tretësirë të përbërë nga 10 gr pleh në 100 ml ujë duhet të jetë jo më pak se 4.5 pH.

4. Klori

Përmbajtja e klorit duhet të jetë jo më shumë se 0.02 % në masë.

5. Analiza e madhësisë së grimcës

Deri në 5% e masës së plehut duhet të kalojë përmes një rrjete site prej 1 mm dhe deri në 3% e masës duhet të kalojë përmes një rrjete site prej 0.5 mm.

6. Metalet e rënda

Në plehrat me bazë nitrat amoni me përmbajtje të lartë azoti nuk duhen të shtohen metale të rënda dhe çdo gjurmë e rastësishme që rezulton nga procesi i prodhimit nuk duhet të kalojë kufijtë, të cilët përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas nenit 9, pika 1 të ligjit nr.10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”. Përmbajtja e bakrit nuk duhet të jetë më shumë se 10 mg/kg.

Për metalet e tjera të rënda nuk ka specifikime*.

* 32003 R 2003 (Celex No). Pjesërisht e përputhshme me rregulloren e Bashkimit European 2003/2003 të Parlamentit dhe Këshillit European, datë 13 tetor 2003 në lidhje me plehrat. Gazeta Zyrtare nr.304, datë 21.11.2003, faqe 0001-0194
6254

VENDIM
Nr.614, datë 7.9.2011

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË NORMAVE TË TRAJTIMIT ME UNIFORMË
TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve e të normave të trajtimit me uniformë për ushtarakët aktivë (oficerë, nënoficerë, ushtarë profesionistë) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe studentët e shkollave të larta ushtarake, brenda dhe jashtë vendit, sipas pasqyrave 1-6, që u bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Kandidatët (kursantët) për nënoficerë dhe ushtarë profesionistë trajtohen me normat e ushtarit profesionist.

2. Ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilët dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, trajtohen me uniformë stërvitjeje shtesë për çdo mision, sipas natyrës dhe kushteve specifike të misionit.

3. Uniforma, gradat, shenjat dhe simbolet, që mbahen në uniformë, jepen falas për ushtarakët e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Ushtarakët aktivë, në momentin e daljes në rezervë apo lirim, për arsye shëndetësore, për shkak ristrukturimi apo për shkak të shkurtimeve në numrin e përgjithshëm të personelit të Forcave të Armatosura, përfitojnë falas një uniformë ceremoniale, të shoqëruar me shenjat dhe simbolet përkatëse.

5. Kur ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura apo ushtaraku në rezervë i thirrur në shërbim aktiv, humbet jetën në krye të detyrës, familjes së tij i jepen falas për ceremoninë e varrimit artikujt, si më poshtë vijon:

a) për oficerët, uniformë ceremoniale, këmishë, kollare dhe këpucë;

b) për nënoficerët dhe ushtarakët profesionistë, kostum pune, këmishë, kollare dhe këpucë.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Vendimi nr.464, datë 2.7.2004 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve dhe të normave të trajtimit me uniformë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

8. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PASQYRA NR.1

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR OFICERËT

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit				Koment
		Në shtabet e strukturave kryesore		Në trupa (batalion e poshtë)		
		Sasia	Afati (vite)	Sasia	Afati (vite)	
UNIFORMA CEREMONIALE DHE E PUNËS						
I	Uniforma ceremoniale, per Forcen Tokesore, Forcen Ajrore, Forcen Detare dhe Policine Ushtarake					
1	Xhakete	1	4	1	5	
2	Pantallona	1	4	1	5	
3	Fund					Opsion ne vend te pantallonave per femrat
4	Kapele ceremoniale	1	4	1	5	
5	Kemishe me minge te gjata	1	2	1	2	
6	Kemishe me minge te shkurtra					Opsion ne vend te kemishes me minge te gjata
II	Uniforma ceremoniale e bardhe, per Forcen Detare					
1	Xhakete	1	3	1	4	
2	Pantallona	1	3	1	4	
3	Kemishe me minge te gjata me jake "polic"	2	3	2	4	
III	Uniforma e punes, per Forcen Tokesore, Forcen Ajrore, Forcen Detare dhe Policine Ushtarak					
1	Xhakete	1	2	1	4	
2	Pantallona	2	2	2	4	
3	Fund					Opsion ne vend te pantallonave per femrat
4	Beret	1	2	1	2	Perdoret ne uniformen e Forces Tokesore, Forces Ajrore dhe Policise Ushtarake
5	Kapele zarf	1	2	1	2	Perdoret ne uniformen e Forces Ajrore ne vend te beretes (opcion)
6	Kapele pune	1	4	1	5	Perdoret vetem ne uniformen e Forces Detare
7	Kemishe me minge te shkurtra	3	2	1	1	
8	Kemishe me minge te gjata	3	2	1	1	
IV	Artikuj te tjere					
1	Kollare	1	3	1	4	
2	Rrip pantallonash	1	3	1	4	
3	Xhuboks (Xhaketon)	1	3	1	4	
4	Xhup dimeror	1	4	1	5	
5	Pardesy					Ospion ne vend te xhupit dimeror
6	Pardesy kundra shiut					Ospion ne vend te xhupit dimeror
7	Pulover	1	4	1	5	
8	Panatallona verore	1	1	1	2	
9	Fund veror					Opsion ne vend te pantallonave per femrat
10	Corape	4	1	2	1	
11	Kepuce	1	1	1	2	
12	Kordoni dekorativ i uniformes ceremoniale	1	10	1	10	
13	Shenja e emrit	1	5	1	5	
14	Suport per medaljet dhe dekoratat	1	10	1	10	
15	Stema dhe distiktive					Jepen pas kualifikimeve

16	Doreza lëkure	1	6	1	6	
17	Doreza ceremoniale					Jepem me rast ceremonish
UNIFORMA E STËRVITJES						
I	Uniforma kamuflazh - woodland, per Forcen Tokesore dhe Forcen Ajrore (perjashtuar personelin fluturues)					
1	Pantallona	1	2	1	1	
2	Xhakete	1	2	1	1	
3	Kapele	1	2	1	1	
4	Kapele e madhe					Vetem per misione
5	Xhup dimeror	1	4	1	3	
6	Bluze me minge te shkurtra	1	1	2	1	
7	Bluze me minge te gjata	1	1	2	1	
8	Pantallona te brendshme (Penevrek)			1	2	
9	Rrip pantallonash	1	3	1	2	
10	Rrip mesi	1	5	1	5	
11	Corape te gjata	1	1	2	1	
12	Kepuce stervitje lekure	1	4	1	1	
13	Kepuce stervitje lekure/neilon (verore)					Opsion ne vend te kepucve te stervitjes te lekures
14	Doreza luftimi					Vetem per misione
II	Uniforma kamuflazh - shkretetire (Vetem per misione)					
1	Pantallona					Vetem per misione
2	Xhakete					Vetem per misione
3	Kapele					Vetem per misione
4	Kapele e madhe					Vetem per misione
5	Xhup dimeror					Vetem per misione
6	Bluze me minge te shkurtra					Vetem per misione
7	Bluze me minge te gjata					Vetem per misione
8	Pantallona te brendshme (Penevrek)					Vetem per misione
9	Rrip pantallonash					Vetem per misione
10	Rrip mesi					Vetem per misione
11	Corape te gjata					Vetem per misione
12	Kepuce stervitje (lekure/neilon)					Vetem per misione
III	Artikuj te tjere per Forcat Speciale					
1	Kominoshe per forcat speciale			1	2	
2	Kapuc maskimi per forcat speciale			1	2	
IV	Uniforma e stervitjes per pilotet					
1	Kominoshe fluturimi	1	5	1	3	
2	Xhuboks lekure fluturimi (Xhaketon)	1	7	1	7	
3	Xhuboks tekstili fluturimi (Xhaketon)	1	6	1	4	
4	Doreza fluturimi	1	5	1	3	
5	Bluze me minge te gjata	1	2	1	1	
6	Pantallona te brendshme (Penevrek)	1	2	1	1	
7	Corape te gjata	1	1	2	1	
8	Kepuce per pilot (lekure)	1	4	1	2	
V	Uniforma e stervitjes per Forcen Detare					
1	Kemishe me minge te gjata	1	1	2	1	
2	Pantallona	1	1	2	1	
3	Kapele model "Bejsbolli"	1	3	1	2	
4	Bluze me minge te shkurtra	1	1	2	1	
5	Bluze me minge te gjata	1	1	2	1	
6	Xhup dimeror	1	4	1	3	
7	Rrip pantallonash	1	3	1	2	
8	Corape te gjata	1	1	2	1	
9	Kepuce stervitje	1	4	1	1	
10	Pantallona lundrimi kundra ujit			1	4	Vetem per personelin lundrues
VI	Uniforma e stervitjes per Policine Ushtarake					

1	Pantallona	1	2	1	1	
2	Xhakete	1	2	1	1	
3	Kapele	1	2	1	1	
4	Xhup dimeror	1	4	1	3	
5	Bluze me minge te shkurtra	1	1	2	1	
6	Bluze me minge te gjata	1	1	2	1	
7	Pantallona te brendshme (Penevrek)			1	2	
8	Rrip pantallonash	1	3	1	2	
9	Rrip mesi	1	5	1	5	
10	Corape te gjata	1	1	2	1	
11	Kepuce stervitje lekure	1	4	1	1	
12	Kepuce stervitje lekure/neilon (verore)					Opsion ne vend te kepuceve te stervitjes te lekures
VII Kostum sportiv						
1	Kostum sportiv (Pantallona+Bluze me minge te gjata)	1	3	1	2	
2	Bluze me minge te shkurtra (T-shirt)	1	3	1	2	
3	Pantallona te shkurtra	1	3	1	2	
4	Kepuce sportive (Atlete)	1	3	1	2	
UNIFORMA E DARKAVE ZYRTARE						
1	Kapele (e njejte me te Forces Detare)	1	12	1	12	
2	Xhakete	1	12	1	12	
3	Pantallona	1	12	1	12	Per meshkujt
4	Fund	1	12	1	12	Per femrat
5	Kemishe me minge te gjata	1	12	1	12	
6	Papion	1	12	1	12	
7	Kostum civil (xhakete dhe pantallona)	1	10	1	10	

Shenim:

1. Gradat dhe dekoracionet qe mbahen ne uniforme jane pjese e uniformes.
2. Oficeret qe transferohen nga nje force/njesi ne tjetren, nuk e nderrojne uniformen, por mbajne uniformen e origjines.
3. Oficeret qe emerohen per here te pare, furnizohen me nje komplet te uniformes se punes dhe uniformes se stervitjes. Ne rast largimi nga Forcat e Armatosura per arsye te nderprerjes se njeanshme te kontrates, ai detyrohet te zhdemtoje vleren e mbetur te uniformes me te cilen eshte furnizuar.

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR NËNOFICERËT

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit				Koment
		Në shtabet e strukturave kryesore		Në trupa (batalion e poshtë)		
		Sasia	Afati (vite)	Sasia	Afati (vite)	
UNIFORMA CEREMONIALE DHE E PUNËS						
II	Uniforma ceremoniale / e punes, per Forcen Tokesore, Forcen Ajrore, Forcen Detare dhe Policine Ushtarak					
1	Xhakete	1	2	1	4	
2	Pantallona	2	2	2	4	
3	Fund					Opsion ne vend te pantallonave per femrat
4	Kapele ceremoniale/e punes	1	4	1	5	Per Forcen Tokesore, Forcen Ajrore dhe Policine Ushtarake
5	Kapele ceremoniale/e punes	1	2	1	3	Per vetem per Forcen Detare
6	Beret	1	2	1	2	Perdoret ne uniformen e Forces Tokesore, Forces Ajrore dhe Policise Ushtarake
7	Kapele zarf	1	2	1	2	Perdoret ne uniformen e Forces Ajrore ne vend te beretes (opcion)
8	Kemishe me minge te shkurtra	3	2	1	1	
9	Kemishe me minge te gjata	3	2	1	1	
III	Artikuj te tjere					
1	Kollare	1	3	1	4	
2	Rrip pantallonash	1	3	1	4	
3	Xhuboks (Xhaketon)	1	3	1	4	
4	Xhup dimeror	1	4	1	5	
5	Pardesy					Ospion ne vend te xhupit dimeror
6	Pardesy kundra shiut					Ospion ne vend te xhupit dimeror
7	Pulover	1	4	1	5	
8	Panatallona verore	1	1	1	2	
9	Fund veror					Opsion ne vend te pantallonave per femrat
10	Corape	4	1	2	1	
11	Kepuce	1	1	1	2	
12	Kordoni dekorativ i uniformes ceremoniale	1	10	1	10	
13	Shenja e emrit	1	5	1	5	
14	Suport per medaljet dhe dekoratat	1	10	1	10	
15	Stema dhe distiktive					Jepen pas kualifikimeve
16	Doreza lekure	1	10	1	10	
17	Doreza ceremoniale					Jepen ne rast ceremonish
UNIFORMA E STËRVITJES						
I	Uniforma kamuflazh - woodland, per Forcen Tokesore dhe Forcen Ajrore					
1	Pantallona	1	2	1	1	
2	Xhakete	1	2	1	1	
3	Kapele	1	2	1	1	
4	Kapele e madhe					Vetem per misione
5	Xhup dimeror	1	4	1	3	
6	Bluze me minge te shkurtra	1	1	2	1	
7	Bluze me minge te gjata	1	1	2	1	
8	Pantallona te brendshme (Penevrek)			1	2	
9	Rrip pantallonash	1	3	1	2	
10	Rrip mesi	1	5	1	5	
11	Corape te gjata	1	1	2	1	
12	Kepuce stervitje lekure	1	4	1	1	

13	Kepuce stervitje lekure/neilon (verore)					Opsion ne vend te kepuceve te stervitjes te lekures
14	Doreza luftimi					Vetem per mision
II Uniforma kamuflazh - shkrete (Vetem per mision)						
1	Pantallona					Vetem per mision
2	Xhakete					Vetem per mision
3	Kapele					Vetem per mision
4	Kapele e madhe					Vetem per mision
5	Xhup dimeror					Vetem per mision
6	Bluze me minge te shkurtra					Vetem per mision
7	Bluze me minge te gjata					Vetem per mision
8	Pantallona te brendshme (Penevrek)					Vetem per mision
9	Rrip pantallonash					Vetem per mision
10	Rrip mesi					Vetem per mision
11	Corape te gjata					Vetem per mision
12	Kepuce stervitje (lekure/neilon)					Vetem per mision
III Artikuj te tjere per Forcat Speciale						
1	Kominoshe per forcat speciale			1	2	
2	Kapuc maskimi per forcat speciale			1	2	
IV Uniforme stervitjes per Forcen Detare						
1	Kemishe me minge te gjata	1	1	2	1	
2	Pantallona	1	1	2	1	
3	Kapele model "Bejsbolli"	1	3	1	2	
4	Bluze me minge te shkurtra	1	1	2	1	
5	Bluze me minge te gjata	1	1	2	1	
6	Xhup dimeror	1	4	1	3	
7	Rrip pantallonash	1	3	1	2	
8	Corape te gjata	1	1	2	1	
9	Kepuce stervitje	1	4	1	1	
10	Pantallona lundrimi kundra ujit			1	4	Vetem per personelin lundrues
VI Uniforme e stervitjes per Policine Ushtarake						
1	Pantallona	1	2	1	1	
2	Xhakete	1	2	1	1	
3	Kapele	1	2	1	1	
4	Xhup dimeror	1	4	1	3	
5	Bluze me minge te shkurtra	1	1	2	1	
6	Bluze me minge te gjata	1	1	2	1	
7	Pantallona te brendshme (Penevrek)			1	2	
8	Rrip pantallonash	1	3	1	2	
9	Rrip mesi	1	5	1	5	
10	Corape te gjata	1	1	2	1	
11	Kepuce stervitje lekure	1	4	1	1	
12	Kepuce stervitje lekure/neilon (verore)					Opsion ne vend te kepuceve te stervitjes te lekures
VII Kostum sportiv						
1	Kostum sportiv (Pantallona+Bluze me minge te gjata)	1	3	1	2	
2	Bluze me minge te shkurtra (T-shirt)	1	3	1	2	
3	Pantallona te shkurtra	1	3	1	2	
4	Kepuce sportive (Atlete)	1	3	1	2	

Shenim:

1. Gradat dhe dekoracionet qe mbahen ne uniforme jane pjese e uniformes.
2. Nenoficeret qe transferohen nga nje force/njese ne tjetren, nuk e nderrojne uniformen, por mbajne uniformen e origjines.
3. Nenoficeret qe emerohen per here te pare, furnizohen me nje komplet te uniformes se punes dhe uniformes se stervitjes. Ne rast largimi nga Forcat e Armatosura per arsye te nderprerjes se njeanshme te kontrates, ai detyrohet te zhdemtoje vleren e mbetur te uniformes me te cilen eshte furnizuar.

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR USHTARËT DHE DETARËT PROFESIONISTË

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Koment
		Sasia	Afati (vite)	
UNIFORMA CEREMONIALE				
I	Uniforma ceremoniale, per Forcen Tokesore, Forcen Ajrore dhe Policine Ushtarake			
1	Xhakete			Jepet vetem ne rast ceremonish
2	Pantallona (ose Fund per femrat)			Jepet vetem ne rast ceremonish
3	Kapele ceremoniale			Jepet vetem ne rast ceremonish
4	Kemishe me minge te gjata			Jepet vetem ne rast ceremonish
II	Uniforme ceremoniale detari			
1	Xhakete dimerore			Jepet vetem ne rast ceremonish
2	Pantallona dimerore			Jepet vetem ne rast ceremonish
3	Xhakete verore			Jepet vetem ne rast ceremonish
4	Pantallona verore			Jepet vetem ne rast ceremonish
5	Kemishe verore			Jepet vetem ne rast ceremonish
6	Kapele detari			Jepet vetem ne rast ceremonish
III	Artikuj te tjere			
1	Kollare			Jepet vetem ne rast ceremonish (me perjashtim te detareve)
2	Rrip pantallonash			Jepet vetem ne rast ceremonish
3	Corape			Jepet vetem ne rast ceremonish
4	Kepuce			Jepet vetem ne rast ceremonish
5	Shenja e emrit			Jepet vetem ne rast ceremonish
6	Doreza ceremoniale			Jepen ne rast ceremonish
UNIFORMA E STERVITJES				
I	Uniforma kamuflazh - woodland, per Forcen Tokesore dhe Forcen Ajrore			
1	Pantallona	1	1	
2	Xhakete	1	1	
3	Kapele	1	1	
5	Kapele e madhe			Vetem per misione
	Beret	1	2	
6	Xhup dimeror	1	3	
7	Bluze me minge te shkurtra	2	1	
8	Bluze me minge te gjata	2	1	
9	Pantallona te brendshme (Penevrek)	1	2	
10	Rrip pantallonash	1	2	
11	Rrip mesi	1	5	
12	Corape te gjata	2	1	
13	Kepuce stervitje lekure	1	1	
14	Kepuce stervitje lekure/neilon (verore)			Opsion ne vend te kepuceve te stervitjes te lekures
15	Doreza luftimi - (Opsion - vetem per misione)			Vetem per misione
II	Uniforma kamuflazh - shkretetire (Vetem per misione)			
1	Pantallona			Vetem per misione
2	Xhakete			Vetem per misione
3	Kapele			Vetem per misione
4	Kapele e madhe			Vetem per misione
5	Xhup dimeror			Vetem per misione
6	Bluze me minge te shkurtra			Vetem per misione
7	Bluze me minge te gjata			Vetem per misione
8	Pantallona te brendshme (Penevrek)			Vetem per misione
9	Rrip pantallonash			Vetem per misione
10	Rrip mesi			Vetem per misione

11	Corape te gjata			Vetem per misione
12	Kepuce stervitje (lekure/neilon)			Vetem per misione
III Uniforma e stervitjes per Forcat Detare				
1	Xhakete stervitje detari	1	1	
2	Pantallona stervitje detari	1	1	
3	Kapele model "Bejsbolli"	1	1	
4	Beret	1	3	
5	Xhup dimeror	1	3	
6	Bluze me minge te shkurtra	2	1	
7	Bluze me minge te gjata	2	1	
8	Pantallona te brendshme (Penevrek)	1	2	
9	Rrip pantallonash	1	2	
10	Corape te gjata	2	1	
11	Kepuce stervitje	1	1	
12	Pantallona lundrimi kundra ujit	1	4	Vetem per personelin lundrues
VI Uniforma e stervitjes per Policine Ushtarake				
1	Pantallona	1	1	
2	Xhakete	1	1	
3	Kapele	1	1	
4	Beret	1	2	
5	Xhup dimeror	1	3	
6	Bluze me minge te shkurtra	2	1	
7	Bluze me minge te gjata	2	1	
8	Pantallona te brendshme (Penevrek)	1	2	
9	Rrip pantallonash	1	2	
10	Rrip mesi	1	5	
11	Corape te gjata	2	1	
12	Kepuce stervitje lekure	1	1	
13	Kepuce stervitje lekure/neilon (verore)			Opsion ne vend te kepuceve te stervitjes te lekures
VII Kostum sportiv				
1	Kostum sportiv (Pantallona+Bluze me minge te gjata)	1	2	
2	Bluze me minge te shkurtra (T-shirt)	1	2	
3	Pantallona te shkurtra	1	2	
4	Kepuce sportive (Atlete)	1	2	

Shenim:

1. Gradat dhe dekoracionet qe mbahen ne uniforme jane pjese e uniformes.
2. Ushtaret dhe detaret profesionist qe transferohen nga nje force/njesi ne tjetren, nuk e nderrojne uniformen, por mbajne uniformen e origjines.
3. Ushtaret dhe detaret profesionist qe emerohen per here te pare, furnizohen me nje komplet te uniformes se stervitjes. Ne rast largimi nga Forcat e Armatosura per arsye te nderprerjes se njeanshme te kontrates, ai detyrohet te zhdemtoje vleren e mbetur te uniformes me te cilen eshte furnizuar.
4. Ushtaraket e truprojes se nderit furnizohen me nje komplet te uniformes se ceremoniale/pune nje here ne tre vjet.

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR ORKESTRËN FRYMORE TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Koment
		Sasia	Afati (vite)	
UNIFORMA CEREMONIALE KONCERTALE DHE E PUNËS				
I	Uniforma ceremoniale			
1	Xhakete	1	3	
2	Pantallona	1	3	
3	Kapele	1	3	
4	Kemishe me minge te gjata me jake "polic"	2	3	
II	Uniforma per koncerte publike			
1	Xhakete	1	5	
2	Pantallona	1	5	
3	Fund			Opsion ne vend te pantallonave per femrat
4	Kapele	1	5	
5	Kemishe me minge te gjata	2	4	
III	Uniforma e punes			
1	Xhakete	1	4	
2	Pantallona	2	4	
3	Fund			Opsion ne vend te pantallonave per femrat
4	Beret	1	2	
7	Kemishe me minge te shkurtra	1	1	
8	Kemishe me minge te gjata	1	1	
III	Artikuj te tjere			
1	Kollare	1	5	
2	Rrip pantallonash	1	3	
3	Rrip mesi per uniformen ceremoniale	1	8	
4	Xhuboks (Xhaketon)	1	5	
5	Xhup dimeror	1	5	
6	Pulover	1	5	
7	Panatallona verore	1	2	
8	Fund veror			Opsion ne vend te pantallonave per femrat
9	Corape	2	1	
10	Kepuce	1	1	
11	Shenja e emrit	1	5	
VII	Kostum sportiv			
1	Kostum sportiv (Pantallona+Bluze me meng te gjata)	1	3	
2	Bluze me minge te shkurtra (T-shirt)	1	3	
3	Panatlona te shkurtra	1	3	
4	Kepuce sportive (Atlete)	1	3	

Shenim:

1. Gradat dhe dekoracionet qe mbahen ne uniforme jane pjese e uniformes.
2. Ushtaraku qe emerohet per here te pare, furnizohet me nje komplet te uniformes ceremoniale, koncertale dhe te punes. Ne rast largimi nga Forcat e Armatosura per arsye te nderprerjes se njeanshme te kontrates, ai detyrohet te zhdemtoje vleren e mbetur te uniformes me te cilen eshte furnizuar.

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR STUDENTËT USHARAKË

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Koment
		Sasia	Afati (vite)	
UNIFORMA CEREMONIALE E STUDENTIT USHTARAK				
I	Uniforma ceremoniale			
1	Xhakete	1	4	
2	Pantallona	1	4	
3	Fund			Opsion per femrat
4	Kapele	1	4	
5	Kemishe me minge te gjata me jake "polic"	2	4	
II	Artikuj te tjere			
1	Rrip pantallonash	1	4	
2	Corape	2	1	
3	Kepuce	1	2	
4	Doreza ceremoniale			Jepen ne rast ceremonish
UNIFORMA E STËRVITJES				
I	Uniforme kamuflazhi - woodland			
1	Pantallona	1	1	
2	Xhakete	1	1	
3	Kapele	1	1	
4	Xhup dimeror	1	3	
5	Bluze me minge te shkurtra	2	1	
6	Bluze me minge te gjata	2	1	
7	Pantallona te brendshme (Penevrek)	1	2	
8	Rrip pantallonash	1	2	
9	Rrip mesi	1	5	
10	Corape te gjata	2	1	
11	Kepuce stervitje lekure	1	1	
II	Kostum sportiv			
1	Kostum sportiv (Pantallona+Bluze me minge te gjata)	1	2	
2	Bluze me minge te shkurtra (T-shirt)	1	2	
3	Pantallona te shkurtra	1	2	
4	Kepuce sportive (Atlete)	1	2	

Shenim:

1. Gradat dhe dekoracionet qe mbahen ne uniforme jane pjese e uniformes.
2. Studentet qe kryejne studime brenda apo jashte vendit, furnizohen qe me fillimin e studimeve me nje komplet te uniformes ceremoniale dhe uniformes se stervitjes. Ne rast largimi, nderprerje te studimeve per arsye disiplinore apo rezultate te ulta, ai detyrohet te zhdemtoje vleren e mbetur te uniformes me te cilen eshte furnizuar.

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR USHTARAKËT QË SHKOJNË NË MISIONE JASHTË VENDIT

Nr.	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Koment
		Sasia	Afati (muaj)	
UNIFORMA E STËRVITJES				
I	Uniforma kamuflazh (woodland apo shkretetire)			
1	Pantallona	1	6	
2	Xhakete	1	6	
3	Kapele	1	6	
5	Kapele e madhe			Ne varesi te llojit te misionit
6	Xhup dimeror	1	6	Ne varesi te llojit dhe kohes se misionit
7	Bluze me minge te shkurtra	2	6	
8	Bluze me minge te gjata	2	6	
9	Pantallona te brendshme (Penevrek)	1	6	Ne varesi te llojit dhe kohes se misionit
12	Corape te gjata	4	6	
13	Kepuce stervitje lekure	1	6	
14	Kepuce stervitje lekure/neilon (verore)			Opsion ne vend te kepuceve te stervitjes te lekures
15	Doreza luftimi - (Opsion - vetem per misione)	1	6	Vetem per misione
II	Kostum sportiv			
1	Kostum sportiv (Pantallona+Bluze me meng te gjata)	1	6	
2	Bluze me minge te shkurtra (T-shirt)	1	6	
3	Panatlona te shkurtra	1	6	
4	Kepuce sportive (Atlete)	1	6	

Shenim:

1. Gradat dhe dekoracionet qe mbahen ne uniforme jane pjese e uniformes.
2. Kompletohen vetem ushtaraket qe marrin pjese ne misione jashte vendit me kohezgjatje mbi 3 muaj.

VENDIM
Nr.615, datë 7.9.2011

PËR KONTRATAT E TREGTIMIT NË LARGËSI TË SHËRBIMEVE FINANCIARE PËR KONSUMATORËT[†]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 36 e 61 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontratat për tregtimin në largësi të shërbimeve financiare për konsumatorët, bazuar në nenet 36, 37, 38 e 39 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, rregullohen sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë vendim.
2. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “Shërbim financiar”, çdo lloj shërbimi me natyrë bankare, kredie, sigurimi, pensioni vullnetar, investimi financiar ose pagese.

[†] Directive 2002/65/EC of the European Parliament and of the Council of 23 September 2002 concerning the distance marketing of consumer financial services and amending Council Directive 90 619 EEC and Directive 97/7/EC and 98/27 EC consolidate version (Celex 02002L0065 Official Journal L271 09/10/2002 P 0016 0024)

b) “Operator i mjeteve të komunikimit në largësi”, çdo person, fizik a juridik, publik a privat, i cili në tregtinë, biznesin ose profesionin e vet bën të disponueshëm për tregtarët një a më shumë mjete të komunikimit në largësi.

3. Dispozitat e këtij vendimi, për rastin e kontratave të shërbimeve financiare në largësi, që përmbajnë një marrëveshje fillestare shërbimi, të ndjekur nga veprime të njëpasnjëshme ose një numër veprimesh të veçanta të së njëjtës natyrë, të kryera me kalimin e kohës, zbatohen vetëm për marrëveshjen fillestare.

4. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen edhe për kontratat në largësi, që shtojnë elemente të reja në marrëveshjen fillestare, sipas pikës 3 të këtij vendimi, për ofrimin e një shërbimi financiar në largësi.

5. Pikat 7, 8, 9 dhe 10 të këtij vendimi në rast se nuk ka marrëveshje fillestare për ofrimin e një shërbimi financiar në largësi, por veprime pasuese ose veprime të veçanta të së njëjtës natyrë, të kryera me kalimin e kohës ndërmjet të njëjtave palë kontraktuese, zbatohen vetëm kur është kryer veprimi i parë.

6. Për rastet sipas pikës 3 të këtij vendimi, dhe kur nuk është kryer asnjë veprim i së njëjtës natyrë për më shumë se një vit, veprimi pasues në një seri të re veprimesh konsiderohet të jetë i pari dhe, në këtë rast, zbatohen pikat 7, 8, 9 dhe 10 të këtij vendimi.

7. Tregtari duhet t’i sigurojë konsumatorit, përpara se ky të pranojë ndonjë ofertë ose të lidhë kontratën për shërbimet financiare në largësi, informacionin për:

a) Tregtarin, ku përfshihen të dhënat për:

i) identitetin dhe veprimtarinë kryesore të tregtarit, adresën ku është vendosur tregtari, si dhe ndonjë adresë tjetër, në lidhje me marrëdhëniet e konsumatorit me tregtarin;

ii) identitetin e përfaqësuesit të tregtarit, të vendosur në Shqipëri, dhe adresën e tij, në lidhje me marrëdhëniet e konsumatorit me këtë përfaqësues, nëse ka një përfaqësues të tillë;

iii) identitetin e personit/profesionistit, cilësinë në të cilën ai është duke vepruar përballë konsumatorit, dhe adresën e tij për marrëdhëniet me konsumatorin, në rastin kur këto marrëdhënie janë edhe me një person/profesionist tjetër, përveç tregtarit;

iv) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS), dhënë tregtarit nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në certifikatën e tij të regjistrimit;

v) adresën dhe të dhënat e organit administrativ apo mbikëqyrës, në rast se veprimtaria e tregtarit është subjekt për lëshimin e një lejeje paraprake nga organi përkatës.

b) Shërbimet financiare, ku përfshihen:

i) një përshkrim i karakteristikave kryesore të shërbimit financiar;

ii) çmimi i përgjithshëm që duhet të paguajë konsumatori për tregtarin, përfshirë të gjitha taksat, tarifat e shpenzimet dhe të gjitha taksat e paguara nga tregtari. Në rast se çmimi i saktë i shërbimit nuk mund të tregohet, atëherë jepet baza për llogaritjen e çmimit, për të bërë të mundur verifikimin e tij nga konsumatori;

iii) njoftimi, nëse është i nevojshëm, se shërbimi financiar është i lidhur me instrumente që përfshijnë rreziqe të veçanta, për karakteristikat e tyre specifike ose për veprime që duhet të kryhen apo për çmimin, i cili varet nga luhatjet në tregjet financiare, jashtë kontrollit të tregtarit, dhe që performancat historike nuk janë tregues për performancat e ardhshme;

iv) njoftimi për mundësinë e ekzistencës së taksave dhe/ose të shpenzimeve të tjera që nuk janë paguar nga tregtari ose vendosur prej tij;

v) çdo kufizim i periudhës, për të cilën informacioni i dhënë është i vlefshëm;

vi) rregullimi i mënyrës së pagesës dhe zbatimit;

vii) çdo shtesë e kostove të veçanta për përdorimin e mjeteve të komunikimit në largësi, në rast se kostoja shtesë i ngarkohet konsumatorit.

c) Kontratat në largësi, ku përfshihen:

i) ekzistenca ose mungesa e së drejtës së heqjes dorë, në bazë të pikave 17, 18 ose 19 të këtij vendimi, dhe, nëse e drejta e heqjes dorë ekziston, kohëzgjatja dhe kushtet për ushtrimin e saj, përfshirë informacionin për shumën që mund t’i kërkohet të paguajë konsumatori, në bazë të pikave 23 dhe 24 të këtij vendimi, si dhe pasojat e mosushtrimit të kësaj të drejte;

ii) kohëzgjatja minimale e kontratës, në rastin kur shërbimet financiare do të kryhen në mënyrë të përhershme ose të përsëritur;

iii) informacioni për çdo të drejtë të palëve, në lidhje me përfundimin e kontratës para kohe ose në mënyrë të njëanshme, mbështetur në kushtet e kontratës në largësi, përfshirë çdo penalizim që vendoset në kontratë për raste të tilla;

iv) udhëzime praktike për ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë, duke treguar, ndërmjet të tjerave, adresën në të cilën duhet të dërgohet njoftimi i heqjes dorë;

v) çdo dispozitë kontraktuale mbi ligjin e zbatueshëm në kontratë dhe/ose mbi gjykatën kompetente;

ç) Dëshmipërblimin për konsumatorin në rastin:

i) kur ekziston apo jo një mekanizëm për zgjidhjen jashtë gjyqësorit të mosmarrëveshjeve dhe për dëshmipërblimin e konsumatorëve, dhe, nëse po, mënyrat për mundësinë e përdorimit të tij;

ii) e ekzistencës së një fondi garancie ose të mënyrave të tjera për kompensimin e konsumatorëve.

8. Tregtari duhet të sigurojë që, në informacionin e përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi, të bëhet i qartë qëllimi i tij tregtar. Ky informacion të jepet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, në çdo rrugë të përshtatshme të mjeteve të përdorura të komunikimit në largësi. Në veçanti, informacioni të jetë në përputhje me parimet e mirëbesimit në transaksionet tregtare, si dhe me parimet që rregullojnë mbrojtjen e atyre, që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk janë në gjendje të japin pëlqimin e tyre.

9. Informacioni i përcaktuar sipas pikës 7 të këtij vendimi, i sigurohet konsumatorit në kohën e duhur, përpara se ai të ngarkohet me ndonjë detyrim sipas kontratës. Informacioni jepet në gjuhën shqipe.

10. Në rastin e komunikimit të iniciuar nga tregtari, me telefon ose me mënyra të tjera të komunikimeve me zë, në largësi, bëhen të qarta, në fillim të çdo bisede me konsumatorin, identiteti i tregtarit dhe qëllimi tregtar i thirrjes.

a) për të siguruar miratimin e shprehur qartë nga konsumatori, është e nevojshme veçanërisht dhënia e informacionit të mëposhtëm:

i) Identiteti i personit në kontakt me konsumatorin dhe lidhja e tij me tregtarin;

ii) Një përshkrim i karakteristikave kryesore të shërbimit financiar;

iii) Çmimi i përgjithshëm, që duhet të paguajë konsumatori për tregtarin, përfshirë të gjitha taksat dhe/ose shpenzimet e tjera të paguara nga tregtari ose, në rast se nuk mund të tregohet një çmim fiks, të jepet baza për llogaritjen e çmimit, për të bërë të mundur verifikimin e tij nga konsumatori;

iv) Njoftimi për mundësinë e ekzistencës së taksave dhe/ose të shpenzimeve të tjera, që nuk janë paguar nga tregtari ose vendosur prej tij;

v) Ekzistenca ose mungesa e së drejtës së heqjes dorë dhe, nëse kjo e drejtë ekziston, të dhëna për kohëzgjatjen e kushtet për ushtrimin e saj, përfshirë informacionin për shumën që mund t'i kërkohej të paguajë konsumatori.

b) Tregtari informon konsumatorin se ka në dispozicion informacion shtesë, me kërkesë të konsumatorit, si dhe për natyrën e këtij informacioni.

11. Tregtari e njofton konsumatorin për të gjitha kushtet e kontratës dhe për informacionin e përcaktuar në pikat 7, 8, 9 dhe 10 të këtij vendimi, me shkrim apo me një mjet tjetër të qëndrueshëm, të disponueshëm dhe të arritshëm për konsumatorin, në një kohë të arsyeshme përpara se konsumatori të pranojë ndonjë ofertë ose të lidhë kontratën për shërbimet financiare në largësi.

12. Tregtari përmbush detyrimet e tij, sipas pikës 11 të këtij vendimi, menjëherë pas lidhjes së kontratës në largësi, nëse kontrata është lidhur me kërkesën e konsumatorit, duke përdorur një mjet të komunikimit në largësi, që nuk mundëson sigurimin e kushteve të kontratës dhe të informacionit, në përputhje me pikën 11 të këtij vendimi.

13. Konsumatorit i jepet e drejta që në çdo kohë gjatë marrëdhënieve kontraktuale, me kërkesën e tij, të marrë me shkrim informacion për kushtet e kontratës. Konsumatorit i jepet e drejta për të ndryshuar mjetin e përdorur të komunikimit në largësi, vetëm në rast se kjo është e papajtueshme me kontratën e lidhur ose me natyrën e shërbimit financiar të ofruar.

14. Konsumatori nuk i kryen asnjë pagesë tregtarit, përfshirë tarifën, komisionet apo shpenzime të tjera, që nuk kanë qenë të përfshira në kushtet e kontratës së lidhur.

15. Informacioni për detyrimet kontraktuale, që u komunikohet konsumatorëve përpara lidhjes së kontratës, duhet të jetë në përputhje me detyrimet e kontratës, të vendosura nga dispozitat e zbatueshme ligjore për kontratën e tregtimit në largësi të shërbimeve financiare, të cilat, me lidhjen e kontratës, prezumohen të zbatueshme në këtë kontratë.

16. Informacioni i dhënë nga tregtari në zbatim të pikave 7-14 të këtij vendimi, duhet të jetë i plotë, i vërtetë, i kuptueshëm dhe joçorientues.

17. Afati prej 14 (katërmëdhjetë) ditësh kalendarike, i përcaktuar në pikën 3 të nenit 37 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, do të fillojë nga data e lidhjes së kontratës ose nga data kur konsumatori merr të dhëna për kushtet e kontratës në largësi dhe informacionin sipas pikave 11 e 12, të këtij vendimi, në rast se kjo datë është më pas datës së lidhjes së kontratës.

18. Konsumatori ka të drejtë, që, për pensionin vullnetar ose për sigurimin e jetës, sipas përcaktimeve në shkronjën “c” të pikës 3 të nenit 37 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, të heqë dorë nga një kontratë në largësi, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh, pa penalizim dhe pa dhënë arsye, duke filluar nga:

a) data e lidhjes së kontratës për pensionin vullnetar ose nga çasti që personi i siguruar është i informuar nga siguruesi për lidhjen e kontratës së sigurimit të jetës;

b) data, kur konsumatori merr informacion për kushtet e kontratës dhe informacionin, sipas pikave 11 dhe 12 të këtij vendimi, në rast se kjo datë është pas datës së lidhjes së kontratës.

19. Pika 18 nuk zbatohet për:

a) shërbimet financiare, çmimi i të cilave varet nga luhatjet e tregut financiar jashtë kontrollit të tregtarit, të ndodhura gjatë afatit të heqjes dorë, ku përfshihen:

i) kursi i këmbimit me monedhat e huaja;

ii) instrumentet e tregut të parasë;

iii) letrat me vlerë të transferueshme;

iv) njësitë në sipërmarrje të investimeve kolektive;

v) kontratat financiare të së ardhmes, përfshirë vendosjen e instrumenteve ekuivalente të pagesës në mjete monetare;

vi) marrëveshjet e huave me normë paraprake;

vii) norma e interesit, ndërkëmbimet e parasë dhe kapitalit;

viii) mundësia për marrjen në pronësi apo disponimin e çdo instrumenti referuar kësaj pike, përfshirë instrumentet ekuivalente të pagesës në mjete monetare. Kjo kategori përfshin në veçanti opsionin në qarkullimin monetar dhe normën e interesit;

b) policat e sigurimit të udhëtimit dhe të bagazheve apo polica të ngjashme të sigurimit afatshkurtër, me kohëzgjatje më pak se një muaj;

c) kontratat, zbatimi i të cilave është përmbushur plotësisht nga të dyja palët me kërkesë të shprehur të konsumatorit, përpara se konsumatori të ushtrojë të drejtën e tij për heqjen dorë;

ç) kontratat për kredi, të përcaktuara kryesisht për qëllimin e blerjes ose ruajtjes së të drejtave të pronës mbi tokën ose mbi një ndërtesë ekzistuese apo të projektuar, ose me qëllim rinovimin a përmirësimin e një ndërtese.

20. Nëse konsumatori ushtron të drejtën e tij të heqjes dorë, njofton tregtarin, përpara mbarimit të afatit të përcaktuar në pikat 17 dhe 18 të këtij vendimi. Afati i fundit konsiderohet të ketë qenë i vënë re nga tregtari, nëse njoftimi, me shkrim apo me një mjet tjetër të qëndrueshëm e të disponueshëm dhe të arritshëm për marrësin, është dërguar përpara mbarimit të afatit.

21. Nëse një kontratë në largësi për një shërbim të caktuar financiar i bashkëngjitet një tjetër kontratë në largësi për shërbimet e ofruara nga tregtari ose nga një palë e tretë, në bazë të një

marrëveshjeje ndërmjet palës së tretë dhe tregtarit, e nëse konsumatori ushtron të drejtën e tij të heqjes dorë, të përcaktuar në pikat 17 dhe 18 të këtij vendimi, kjo kontratë shtesë do të anulohet, pa penalizim.

22. Pikat 17 dhe 18 të këtij vendimi, nuk zbatohen për anulimin e kontratave të kredisë, të parashikuara në nenet 37, pika 4, e 43, pika 7, të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar.

23. Kur konsumatori ushtron të drejtën e tij të heqjes dorë nga një kontratë për shërbimet financiare në largësi, sipas përcaktimeve në pikat 17 dhe 18 të këtij vendimi, konsumatorit i kërkohet t’i paguajë tregtarit vetëm vlerën e shërbimit financiar, të ofruar sipas kontratës.

24. Zbatimi i kontratës mund të fillojë përpara mbarimit të afatit për ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë, vetëm me miratimin e shprehur qartë të konsumatorit, me anën e të cilit konsumatori nuk e humbet këtë të drejtë. Shuma për t’u paguar nga konsumatori nuk do të tejkalojë vlerën, e cila është në përpjesëtim me shkallën e ofruar të shërbimit, krahasuar me mbulimin e plotë të kontratës. Kjo shumë, në asnjë rast, nuk do të jetë e tillë që të mund të interpretohet si penalizim.

25. Tregtari nuk mund të kërkojë pagesën për shërbimin financiar të ofruar, nëse ai ka filluar zbatimin e kontratës, përpara mbarimit të periudhës së heqjes dorë, sipas përcaktimeve në pikat 17 dhe 18 të këtij vendimi, dhe pa një kërkesë paraprake të konsumatorit.

26. Tregtari njofton konsumatorin, në një mënyrë të përshtatshme, për shumën që duhet paguar, përpara lidhjes së kontratës, në zbatim të nënndarjes “i” të shkronjës “c” të pikës 7 të këtij vendimi.

27. Nëse konsumatori ka ushtruar të drejtën e tij të heqjes dorë nga kontrata në largësi, tregtari nuk mund t’i kërkojë konsumatorit të paguajë për shërbimin e marrë, përderisa ai të mund të provojë se konsumatori është njoftuar në mënyrën e duhur, për shumën që duhet të paguajë.

28. Tregtari, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike duke filluar nga data, kur ai merr njoftimin e heqjes dorë së konsumatorit, i kthen konsumatorit çdo shumë dhe/ose pronë që ai ka marrë prej tij, në përputhje me kontratën në largësi, me përjashtim të shumës së përcaktuar në pikat 23 dhe 24 të këtij vendimi.

29. Konsumatori i kthen tregtarit çdo shumë dhe/ose pronë, që ai ka marrë sipas kontratës në largësi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data kur konsumatori njofton për heqjen dorë nga kontrata në largësi.

30. Kur konsumatori merr një shërbim financiar pa kërkesën e tij paraprake e të qartë, ai përjashtohet nga çdo detyrim për të paguar tregtarin. Mungesa e përgjigjes nga konsumatori nuk përbën miratim.

31. Nëse kërkesat e përcaktuara në pikat 7, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të këtij vendimi, nuk janë zbatuar, konsumatori mund të anulojë kontratën, pa penalizim, brenda një muaji nga mbarimi i periudhës së përcaktuar në pikat 17 dhe 18 të këtij vendimi.

32. Mesazhet tregtare, të përdorura për ofrimin e shërbimit financiar, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të jenë lehtësisht të dallueshme si tregtare;
- b) Të lejojnë identifikimin e qartë të tregtarit, në emër të të cilit ata u bënë;
- c) Të japin, në mënyrë të qartë dhe jo të dyshimtë, ofertën për konkurrim apo oferta të tjera promociionale, si të tilla;
- ç) Të paraqesin, në mënyrë të qartë dhe jo të dyshimtë, kushtet për pjesëmarrje në konkurrenca, sipas shkronjës “c” të kësaj pike.

33. Konsumatorit i kërkohet pëlqimi paraprak nga tregtari, në rast të përdorimit të teknikave të mëposhtme të komunikimit në largësi:

- a) Sistemeve të automatizuara të thirrjeve pa ndërhyrjen e njeriut;
- b) Aparateve të faksit;
- c) Teknikave të tjera të komunikimit në distancë, që mundësojnë komunikimin individual, përveç atyre të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike.

34. Përdorimi nga tregtari i teknikave të komunikimit në largësi, të përcaktuara në pikën 33 të këtij vendimi, nuk duhet të shkaktojë kosto për konsumatorët.

35. Në rastin e kontratave për shërbime financiare në largësi, tregtari është i detyruar të provojë se:

- a) ka përmbushur detyrimet e tij për t'i dhënë informacion konsumatorit;
- b) ka respektuar afatet e parashikuara në pikat 17 dhe 18 të këtij vendimi;
- c) ka marrë pëlqimin e konsumatorit, për lidhjen e kontratës dhe, kur është e përcaktuar, për zbatimin e saj brenda periudhës së vlefshmërisë për ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë.

36. Informacioni i dhënë përpara lidhjes së kontratës në largësi dhe deklaratimet e bëra përmes telefonit, mjeteve të tjera të komunikimit në largësi me zë, lidhjeve video apo postës elektronike regjistrohen me pëlqimin e palës tjetër dhe do të kenë fuqinë e provës, për verifikimin e rrethanave që përmbahen në to.

37. Çdo dispozitë në kontratën për shërbimet financiare në largësi, që parashikon se barra e provës për plotësimin e detyrimeve të tregtarit bie mbi konsumatorin, është e pavlefshme dhe shfuqizohet.

38. Të drejtat e dhëna konsumatorit, sipas këtij vendimi, nuk mund të kufizohen, edhe nëse ligji i zbatueshëm në kontratë është ai i një shteti tjetër, sipas parashikimeve në dispozitat e legjislationit shqiptar mbi të drejtën ndërkombëtare private. Çdo dispozitë në kontratë, që pengon zbatimin e këtij vendimi, si dhe çdo masë që përjashton ose kufizon të drejtat e konsumatorëve, do të konsiderohen të pavlefshme dhe shfuqizohen.

39. Çdo heqje dorë e konsumatorit nga të drejtat e dhëna sipas këtij vendimi do të konsiderohet e pavlefshme dhe shfuqizohet.

40. Çdo pretendim për ndalimin e shkeljes në bazë të këtij vendimi, në lidhje me veprimet ose praktikatat tregtare, që prekin interesat kolektivë të konsumatorëve, do të paraqitet sipas kushteve dhe në zbatim të nenit 55 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar.

41. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.616, datë 7.9.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “STARAVECKË NR.1 DHE STARAVECKË
NR.2” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663 datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Staraveckë nr.1 dhe Staraveckë nr.2” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 % të pikëve për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese për zgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “Realty & Energy” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Staraveckë nr.1 dhe Staraveckë nr.2” të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.617, datë 7.9.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “BLLICË” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Bllicë” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 % të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Sufa” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Bllicë” të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.618, datë 7.9.2011

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1707, DATË 29.12.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR LËSHIMIN E
PATENTAVE PËR SHPIKJET DHE MODELET E PËRDORIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 202 të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin “Rregullore për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1707, datë 29.12.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I “Dispozita të përgjithshme”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas nënpikës 3.3 të pikës 3 “Parime të përgjithshme”, shtohen pikat 3.4 dhe 3.5, me këtë përmbajtje:

“3.4 DPPM-ja regjistron, në regjistrin e patentave, përfaqësuesin e autorizuar, i cili është caktuar si përfaqësues nga aplikanti ose pronari i patentës me anë të një autorizimi të përgjithshëm, që i jep përfaqësuesit të drejtën të përfaqësojë aplikantin ose pronarin e patentës në të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, dhe nga kjo rregullore, që përfshijnë procedurat për lëshimin e patentës dhe ndryshimet e mëvonshme në regjistrin e patentave.

3.5 Aplikimet e paraqitura pranë DPPM-së nga një përfaqësues i autorizuar, i regjistruar si përfaqësues në regjistrin e patentave për një patentë të caktuar, nuk është e nevojshme të përmbajnë autorizim përfaqësimi. Kur aplikanti ose pronari i një patente e ka revokuar autorizimin e përfaqësimit të regjistruar pranë DPPM-së, ai duhet të depozitojë pranë DPPM-së autorizimin për përfaqësuesin e ri, i cili regjistrohet në regjistrin e patentave sipas parashikimeve të pikës 3.4 të këtij kreu.”.

2. Në kreun VIII “E drejta për prioritet”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Nën-pika 1.5 e pikës 1 “Depozitimi i dokumentit të prioritetit”, shfuqizohet.

b) Pas pikës 1 të kreut VIII shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Deklarimi i prioritetit

2.1 Deklarimi i prioritetit, i përmendur në nenin 24, paragrafi 1, paraqitet me depozitimin e kërkesës për patentë dhe duhet të përmbajë datën dhe numrin e aplikimit të mëparshëm, si dhe shtetin palë në Konventën e Parisit ose anëtar në Organizatën Botërore të Tregtisë, ku është bërë aplikimi i mëparshëm. Në rastin kur prioriteti kërkohet në bazë të paraqitjes në një ekspozitë ndërkombëtare, deklarata duhet të përmbajë datën e paraqitjes në ekspozitë dhe emërtimin e ekspozitës.

2.2 Kërkuesi mund të korrigjojë deklaratën e prioritetit brenda gjashtëmbëdhjetë muajve nga data e prioritetit më të parë të pretenduar, ose, nëse korrigjimi do të shkaktonte një ndryshim në datën e prioritetit më të parë të pretenduar, brenda gjashtëmbëdhjetë muajve nga data e korrigjuar e prioritetit më të parë, cilado periudhë gjashtëmbëdhjetëmuajore të mbarojë më parë, me kusht që një korrigjim i tillë të paraqitet para mbarimit të katër muajve nga data e depozitimit të dhënë të kërkesës për patentë.

2.3 Deklarata e prioritetit nuk mund të bëhet ose të korrigjohet pas depozitimit të kërkesës për publikim të parakohshëm.”.

3. Pas pikës 3 të kreut X “Publikimi i aplikimeve për patentë dhe i patentave”, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Publikimi i patentave të pavlefshme

4.1 DPPM-ja publikon të dhënat për patentat e bëra të pavlefshme për shkak të mospagimit të tarifës së ripërtëritjes, ose kur pavlefshmëria e patentës është vendosur me vendim gjyqate, si dhe në çdo rast tjetër pavlefshmërie parashikuar nga ligji dhe nga kjo rregullore.”.

4. Në kreun XII, “Rivendosja e të drejtave”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) në pikën 1, “Paraqitja e kërkesës”, bëhen këto ndryshime:

i) në nënpikën 1.1, shprehja “...brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e aplikimit për patentë ose të ndonjë aplikimi tjetër...” zëvendësohet me “...brenda dy muajve nga mënjanimi i shkakut të mosrespektimit të afatit, por jo më vonë se 1 (një) vit nga mbarimi i afatit të parespektuar...”.

ii) në nënpikën 1.2, shprehja “...në çdo kohë...” zëvendësohet me “...brenda 2 (dy) muajve nga data e mbarimit të shkakut pengues ose brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e mbarimit të

periudhës shtesë për pagesën e tarifës së ripërtëritjes, parashikuar nga pika 3 e nenit 41 të ligjit, cilado nga periudhat e mësipërme mbaron më herët...”.

iii) Pas pikës 1.2 shtohet pika 1.3, me këtë përmbajtje:

“1.3 Kur një kopje e aplikimit më të hershëm, të kërkuar sipas pikës 2 të nenit 24 të ligjit, nuk është depozituar pranë DPPM-së brenda afatit kohor të caktuar, aplikanti ka të drejtë të kërkojë rivendosjen e të drejtës prioritare nëse:

a) deklarata për prioritet është paraqitur pranë DPPM-së në përputhje me kërkesat e pikës 2.1, të kreut VIII, të kësaj rregulloreje;

b) kërkesa për rivendosje, së bashku me kopjen e aplikimit më të hershëm, është depozituar pranë DPPM-së brenda 1 (një) muaji nga data e mbarimit të afatit të parashikuar nga pika 2 e nenit 24, të ligjit.”.

b) Pas nënpikës 2.3 të pikës 2 “Shqyrtimi i kërkesës nga DPPM-ja”, shtohet nënpika 2.4, me këtë përmbajtje:

“2.4 Vendimi i DPPM-së për refuzimin e rivendosjes në afat mund të apelohej në Bordin e Apelit të DPPM-së brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes njoftim.”.

5. Në kreun XVI, “Ripërtëritja e patentës”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “b” e nënpikës 1.1 të pikës 1 “Paraqitja e kërkesës”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) autorizimin e përfaqësimit për ripërtëritjen e patentës, kur paraqitësi i kërkesës nuk është i regjistruar në regjistrin e patentave si përfaqësues i autorizuar i pronarit të patentës për patentën që kërkohet të ripërtërihet.”.

b) në pikën 2 “Kushtet që duhet të plotësojë kërkesa për ripërtëritje të patentës”, shtohen nënpikat 2.2 dhe 2.3, me këtë përmbajtje:

“2.2 Kërkesa për ripërtëritjen e patentës dhe pagesa e tarifës së ripërtëritjes nuk mund të bëhet më parë se 12 (dymbëdhjetë) muaj që paraprijnë datën e fundit të afatit për kryerjen e pagesës së ripërtëritjes.

2.3 Në rastet kur është vendosur rivendosja e së drejtës për një patentë që është bërë e pavlefshme për shkak të mospagimit brenda afatit të tarifës së ripërtëritjes, pagesa e tarifave të ripërtëritjes për vitet e papaguara do të bëhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e marrjes së njoftimit për rivendosjen e të drejtës.”.

c) Pika 3 “Shqyrtimi i kërkesës nga DPPM-ja” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPM-ja

3.1. DPPM-ja shqyrton kërkesën për ripërtëritjen e patentës dhe, në rast se ka të meta që kanë të bëjnë me pagesën e tarifës së ripërtëritjes, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda periudhës gjashtëmuajore pas datës së fundit të muajit të datës së depozitimit, kundrejt pagesës së një tarife shtesë, në të kundërt ajo refuzon aplikimin për ripërtëritjen e patentës.

3.2. Nëse të metat e kërkesës për ripërtëritje janë të tilla që nuk lejojnë të kuptohet se cila patentë kërkohet të ripërtërihet, DPPM-ja njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 (tre) muajve nga data e njoftimit, në të kundërt ajo refuzon kërkesën.

3.3. Kur kërkesa për ripërtëritjen e patentës është paraqitur nga një person i paautorizuar nga pronari i patentës, DPPM-ja e ripërtërin patentën dhe bën shënimin për ripërtëritjen e saj në regjistrin e patentave, por nuk i lëshon paraqitësit të kërkesës njoftim për ripërtëritjen e patentës.

3.4. Kur për një patentë janë paraqitur disa kërkesa për ripërtëritje, ripërtëritja e patentës bëhet në bazë të kërkesës që është paraqitur e para dhe DPPM-ja nuk merr në shqyrtim kërkesat e mëvonshme. Kur kërkesa e mëvonshme për ripërtëritje paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar i patentës, DPPM-ja e njofton atë për statusin aktual të patentës.

3.5. Nëse tarifa e ripërtëritjes nuk është paguar brenda afatit të parashikuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 41 të ligjit, patenta konsiderohet se ka mbaruar në ditën që tarifa e ripërtëritjes ishte për t’u paguar dhe DPPM-ja njofton pronarin ose përfaqësuesin e autorizuar, të regjistruar në regjistrin e patentave, për skadimin e patentës.”.

ç) Në nënpikën 4.1, të pikës 4 “Ripërtëritja e patentave të licencuara”, pas shprehjes “DPPM-ja njofton të licencuarin...”, shtohen fjalët “..., jo më vonë se 8 (tetë) javë para mbarimit të afatit për pagesën e ripërtëritjes,...”.

6. Në kreun XVII “Dorëheqja nga patenta dhe ndryshimet në një patentë”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1, titulli “Paraqitja e kërkesës” zëvendësohet me “Paraqitja e kërkesës për regjistrimin e dorëheqjes nga patenta”.

b) Në pikën 2, nënpikat 2.3 dhe 2.4 shfuqizohen.

c) Pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“3. Paraqitja e kërkesës për regjistrimin, në regjistrin e patentave, të ndryshimeve në pretendimet e një patente

3.1. Pronari i një patente mund të kërkojë regjistrimin, në regjistrin e patentave, të ndryshimeve në pretendimet e një patente, kur këto ndryshime janë rezultat i një procedure të parashikuar nga pika 3 e nenit 82 të ligjit, brenda afatit të parashikuar në këtë nen. Kërkesa për ndryshimin e pretendimeve përbëhet nga:

a) formulari FP7, i nënshkruar nga pronari i patentës ose përfaqësuesi i tij;

b) autorizimi i përfaqësimit, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës;

c) dokumenti i pagesës së tarifës së publikimit, parashikuar nga pika 3, e nenit 82 të ligjit;

ç) pretendimet e ndryshuara, të përkthyer në gjuhën shqipe e të noterizuara në formë shkresore dhe elektronike.

d) vendimi për ripërtëritjen e patentës me pretendime të ndryshuara.

4. Shqyrtimi i kërkesës për ndryshimin e pretendimeve të patentës

4.1. DPPM-ja shqyrton kërkesën për regjistrimin, në regjistrin e patentave, të ndryshimeve në pretendimet e një patente, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 3 të këtij kreu dhe, në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 (tre) muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

4.2 Kur kërkesa për regjistrimin, në regjistrin e patentave, të ndryshimeve në pretendimet e një patente është në përputhje me parashikimet e pikës 3 të këtij kreu, DPPM-ja regjistron ndryshimet në pretendimet e patentës në regjistrin e patentave, njofton aplikantin dhe publikon ndryshimet në Buletinin e Pronësisë Industriale.

5. Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës për ndryshime në patentë

5.1 Pronari i një patente mund të kërkojë, nëpërmjet një kerkese me shkrim depozituar pranë DPPM-së dhe kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, bërjen e ndryshimeve në një patentë për korrigjimin e gabimeve apo pasaktësive formale të paqëllimshme, kur këto gabime janë bërë nga aplikanti në aplikimin për patentë dhe që nuk kanë të bëjnë me thelbin e patentës. DPPM-ja, pasi shqyrton kërkesën, njofton kërkuuesin për vendimin e marrë dhe, kur e pranon kërkesën, publikon ndryshimet e patentës në Buletinin e Pronësisë Industriale.”.

7. Në fund të nënpikës 5.1 të pikës 5 “Korrigjimi i gabimeve në dokumentet e lëshuara nga DPPM-ja”, të kreut XXII “Inspektimi i dosjes dhe dokumenteve të tjera që lëshon DPPM-ja lidhur me patentat”, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kur rilëshimi i aktit është i pamundur, DPPM-ja bën korrigjimin e gabimit në regjistrin e patentave dhe njofton, me shkrim, aplikantin ose pronarin e patentës për korrigjimin e bërë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.621, datë 7.9.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “ZEREC 1” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Zerrec 1” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 % të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Korça ndërtim - prodhim - A” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Zerrec 1” të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.622, datë 7.9.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR TIRANË - ELBASAN (LOTI I)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë - Elbasan (loti I).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për objekte me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 17 516 359.8 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë pikë tetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 17 516 359.8 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë pikë tetë) lekësh, të përballohet nga “Zëri i investimeve”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, për vitin 2011.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.9.2011 dhe të përfundojë më 15.12.2011.

7. Pronarët e objekteve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ALUIZNI”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit dhe i regjistrimit në ZVRPP Tiranë, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT NDËRTIMIT TË AKSIT “TIRANË
ELBASAN (UNAZA E RE E TIRANËS – MULLET, LOTI I)”

Lloji i pasurisë së paluajtshme: objekte

Nr.	Pronari			Zk			Shënime
	Emri		Mbiemri		Vlera në lekë sipas preventivit	Lloji i objektit	
1	Kadri	Sefer	Husha	2704	3432742.8	Sistemime	Komfirmuar nga ALUIZNI
2	Viktor	Gjet	Frroku	2704	8272623	Lokal 2 KT	Komfirmuar nga ALUIZNI
3	Rodolf		Brahu	3266	5810994	Banesë 3 KT	Komfirmuar nga ALUIZNI
	Totali				17 516 359.8		

VENDIM
Nr.623, datë 7.9.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “BATRA NR. 1, NR. 2 DHE NR. 3”, DHE
MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I
JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Batra nr.1, nr.2 dhe nr.3” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 % të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “KEA” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Batra nr.1, nr.2 dhe nr.3” të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.624, datë 7.9.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË RROGOZHINË, TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Rrogozhinë, të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 380 (treqind e tetëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Rrogozhinë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1 - 2	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
4-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
11-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën shëndetit publik	Në pronësi
21-23	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
16-20	Shërbime funerale	Në pronësi
32-57, 59-280, 282-285, 288, 291, 292	Troje të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
281, 343-360, 363	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
28	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
13-15,	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
26-27	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
367-370	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim SAMT ka vënë në dispozicion të AKKP-së sipërfaqen prej 135.08 ha tokë bujqësore, në zonën kadastrale 3235, fshati: Rrogozhinë Fshat.
371, 374, 377-379	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
380	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
325	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.625, datë 7.9.2011

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “A” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, shtohen personat e renditur në listën “a”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë, me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për talibanët dhe organizatën Al-Qaida.

2. Në fund të shkronjës “C” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë, me organizatën Al-Qaida”, shtohen personat e renditur në listën “b”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë, me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për talibanët dhe organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

A. Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët

1. BADRUDDIN; HAQQANI

B. Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida

1. IBRAHIM; HASSAN; TALI; AL-ASIRI

2. DOKU; KHAMATOVICH; UMAROV

3. OTHMAN; AHMED; OTHMAN; AL- GHAMDI

4. ABDUL RAHIM; BA’AYSIR

5. UMAR; PATEK

VENDIM
Nr.626, datë 7.9.2011

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.563, DATË 14.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME TË BASHKËPUNIMIT TË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR ME AGJENCINË E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA, SI DHE PAGESËN PËRKATËSE PËR SHËRBIMIN E PËRMBARIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14 pika 4, e 28 pika 4 të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.563, datë 14.7.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas kreut III shtohet kreu III/1, me këtë përmbajtje:

“KREU III/1
EKZEKUTIMI I AKTIT TË REVOKIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA/TË KONFISKUARA

1. Agjencia njofton përmbaruesin gjyqësor dhe, nëpërmjet tij, pronarin e pasurisë së sekuestruar/konfiskuar për aktin e revokimit të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar.

2. Dorëzimi i pasurisë së revokuar te pronari i pasurisë bëhet sipas procedurave të Kodit të Procedurës Civile dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, të cilin përmbaruesi gjyqësor e merr nga administratori i pasurisë.

3. Në rastin e mosmarrjes në dorëzim të pasurisë nga pronari i saj, me kalimin e afatit 30 - ditor nga data e marrjes së njoftimit të aktit të revokimit të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, Agjencia i kërkon gjykatës, që ka vendosur revokimin e aktit, heqjen nga administrimi i saj të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar.”.

2. Kreu IV ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KREU IV
PAGESAT PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR

1. Pagesat e shërbimit përmbarimor për ekzekutimin e aktit të sekuestrimit/konfiskimit përcaktohen sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Agjencia përjashtohet nga pagesa paraprake e shërbimit për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit/konfiskimit.

3. Tarifat e përcaktuara në këtë vendim aplikohen dhe për pagesat e shërbimeve përmbarimore, të cilat nuk janë kryer nga Agjencia deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1

	Tarifa për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor	Tarifa në lekë
1	Për vënie dhe ekzekutim të aktit të sekuestrimit të pasurive	5 000
2	Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor	500
3	Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit	500

VENDIM
Nr.627, datë 31.8.2011

**PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË
PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME E TË EDUKIMIT NË
DISTANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2011 - 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2011 - 2012, të jenë 9350 , të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme; | 8570; |
| b) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë; | 40; |
| c) Kuotat për transferim studimesh | 200; |
| ç) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj | 400; |
| d) Kuotat për personat që nuk shikojnë | 20; |
| dh) Kuotat për romët/ballkano – egjiptianë | 20; |
| e) Kuotat për të përndjekurit politikë | 100. |

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas kolonës D të tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kuotat e çdo programi studimi ndahen në raportin 4:1, përkatësisht, 80 % të tyre për pranimet e reja, për programe studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe 20 % për pranimet e reja për programe të dyta studimi.

3. Kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuotat e përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, shpërndahen sipas kolonës E të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe. Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja.

5. Kuotat e pranimeve për personat që nuk shikojnë ndahen, për kandidatët me statusin për personat që nuk shikojnë, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

6. Kuotat e pranimeve për romët dhe ballkano – egjiptianët ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e Romëve dhe Shoqata Kombëtare e Ballkano-Egjiptianëve.

7. Kuotat e pranimeve për të përndjekurit politikë ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë dhe pas plotësimit të kriterëve të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë.

8. Çdo shtetas shqiptar, i cili ka përfunduar shkollën e mesme dhe zotëron diplomë të Maturës Shtetërore, dëftesë pjekurie apo çdo diplomë tjetër studimi, të fituar brenda ose jashtë vendit, të barasvlershme me të, ka të drejtë të aplikojë për në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë. Kandidatëve me diplomë të Maturës Shtetërore të vitit 2010 mesatarja e konkurrimit u llogaritet në bazë të 5 (pesë) komponentëve: mesatares së shkollës së mesme dhe 4 (katër) provimeve të maturës shtetërore.

9. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës, të përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1, të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara e të bëra publike paraprakisht.

10. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin studimet me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, brenda kuotës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, e fitojnë këtë të drejtë, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë e të bëra publike paraprakisht.

11. Tarifat e shkollimit për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme dhe edukimit në distancë, për vitin akademik 2011-2012, përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Financave.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1
KUOTAT CIKËL I PARË, KOHË E PJESSHME DHE EDUKIM NË DISTANCË 2011-2012

A	B	C	D	E
K. UNIVERSITETI	K_ID_PROGRA. MIT	K_EMËRTIMI_I PROGRAMIT	Kuota për studentë shqiptarë	Kuota nga trojet dhe për huajt
Universiteti i Tiranës	1	Histori	250	10
Universiteti i Tiranës	2	Gjeografi	250	10
Universiteti i Tiranës	3	Gjuhë-letërsi	250	10
Universiteti i Tiranës	4	Biologji	250	10
Universiteti i Tiranës	5	Punë sociale	120	8
Universiteti i Tiranës	6	Psikologji	120	8
Universiteti i Tiranës	7	Sociologji	120	8
Universiteti i Tiranës	8	Drejtësi	250	8
Universiteti i Tiranës	9	Infermieri e Përgjithshme	150	8
Universiteti i Tiranës	10	Mami	20	1
Universiteti i Tiranës	11	Teknik i lartë laborator	50	2
Universiteti i Tiranës	12	Fizioterapi	30	1
Universiteti i Tiranës	13	Imazheri	50	2
Universiteti i Tiranës	14	Administrim -Biznes	150	5
Universiteti i Tiranës	15	Financë-kontabilitet	150	5
Univ. Bujqësor Tiranës	16	Prodhim Bimor	100	5
Univ. Bujqësor i Tiranës	17	Agromekanizim	60	3
Univ. Bujqësor i Tiranës	18	Zootehni dhe Biznes Blegtoral	50	3
Univ. Bujqësor i Tiranës	19	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi	50	3
Univ. Bujqësor i Tiranës	20	Hortikulturë	100	5
Univ. Bujqësor i Tiranës	21	Mbrojtje bimësh	100	5
Univ. Bujqësor i Tiranës	22	Agromjedis dhe ekologji	120	5
Univ. Bujqësor i Tiranës	23	Drejtëm agrobiznesi	120	5
Univ. Bujqësor i Tiranës	24	Ekonomi dhe politikë agrare	120	5
Univ. Bujqësor i Tiranës	25	Financë-kontabilitet	120	5
Univ. Bujqësor i Tiranës	26	Teknologji agro-ushqimore	70	4
Univ. Bujqësor i Tiranës	27	Vreshtari-enologji	40	2
Univ. Bujqësor i Tiranës	28	Mbarështim-shfrytëzim	60	3
Univ. Bujqësor i Tiranës	29	Përpunim druri	60	3
Univ. Politehnik i Tiranës	30	Inxhinieri logjistike prodhimi	40	2
Univ. "Fan S. Noli Korçë	31	Gjuhë-letërsi	100	5
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	32	Cikël i ulët	60	3
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	33	Cikël i ulët parashkollor	60	3
Univ. "Fan S. Noli Korçë	34	Financë-kontabilitet	100	5
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	35	Menaxhim	100	5
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	36	Marketing	100	5
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	37	Turizëm	100	5
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	38	Turizëm (filiali Pogradec)	50	2
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	39	Agro-ushqim	60	3
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	40	Agrobiznes	60	3
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	41	Hortikulturë	50	2
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	42	Infermieri e përgjithshme	120	6
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	44	Matematikë-fizikë	100	5
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	45	Biologji-kimi	100	5
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	46	Teknologji informacioni	100	5
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	47	Infermieri e përgjithshme	130	5
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	48	Administrim -biznes	120	6
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	49	Financë-kontabilitet	120	6
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	50	Ekonomia dhe e drejta	100	5
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	51	Arsimi fillor	100	5
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	52	Arsimi parashkollor	100	5
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	53	Edukatë qytetare	80	4
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	54	Punë Sociale	100	5
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	55	Filozofi-Sociologji	80	4
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	56	Gjuhë-letërsi	100	5
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	57	Histori-gjeografi	100	5
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	58	Matematikë-fizikë	100	5

Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	59	Biologji-kimi	100	5
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	60	Histori-gjeografi	120	6
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	61	Gjuhë-letërsi shqipe	120	6
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	62	Mësuesi për arsimin parashkollor	100	5
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	63	Mësuesi për arsimin fillor	100	5
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	64	Kontabilitet-financë	100	5
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	65	Administrim publik	100	5
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	66	Turizëm	80	4
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	67	Fizikë	60	3
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	68	Biologji-Kimi	60	3
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	69	Gjuhë-Letërsi	90	3
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	70	Histori	90	4
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	71	Gjeografi	90	4
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	72	Cikël i Ulët	120	6
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	73	Cikël i ulët parashkollor	90	4
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	74	Financë-kontabilitet	100	5
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	75	Administrim -biznes	100	5
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	76	Turizëm	100	5
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	77	Juridik	120	6
Univ. "A. Moisiu" Durrës	78	Administrim biznesi	180	6
Univ. "A. Moisiu" Durrës	79	Financë-kontabilitet	180	6
Univ. "A. Moisiu" Durrës	80	Cikël i ulët	50	3
Univ. "A. Moisiu" Durrës	81	Psikologji-Sociologji	50	3
Univ. "A. Moisiu" Durrës	82	Infermieri e përgjithshme	100	5
Univ. "A. Moisiu" Durrës	83	Drejtësi	100	5
Univ. "A. Moisiu" (Filiali Peshkopi)	84	Cikël i ulët	100	3
Univ. "A. Moisiu" Durrës (Filiali Peshkopi)	85	Financë-kontabilitet	100	4
		Totali	8610	400

VENDIM
Nr.629, datë 7.9.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E FINANCEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, programi "Menaxhimi i të ardhurave tatimore", t'i shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për shpenzime korente.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.630, datë 14.9.2011

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT QENDROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15 e 56 të ligjit nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Qendror organizohet si institucion qendror, pa degë në territor.
 2. Inspektorati Qendror drejtohet nga Inspektori i Përgjithshëm dhe organizohet në drejtori dhe sektorë për kryerjen e funksioneve të parashikuara në ligjin nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
 3. Inspektori i Përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, sipas procedurave të parashikuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”.
 4. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Inspektoratit Qendror është 12 (dymbëdhjetë) dhe përballohet nga rialokimi dhe reduktimi i 2 (dy) pozicioneve në ministrinë e mëposhtme:
 - Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
 - Ministria e Punëve Publike dhe Transportit;
 - Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
 - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
 - Ministria e Shëndetësisë.
 5. Inspektorati Qendror identifikohet me stemën dhe vulën e tij zyrtare.
 6. Fondet për shpenzime korente, në shumën 2 000 000 (dy milionë) lekë, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 7. Ngarkohet Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ministrinë e përmendura në pikën 4 për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.631, datë 14.9.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z. MUSA
ULQINI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të kurimit të z. Musa Ulqini.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.632, datë 14.9.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM, TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË ZNJ. VALENTINA LONDO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave:

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj. Valentina Londo.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.648, datë 29.9.2011

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT “REPARTI I PRESTARISË DHE ZYRA”, NË ADMINISTRIM TË “NPV USHTRISË” SHA, TIRANË”, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 82 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit “Repart i prestarisë dhe zyra”, në administrim të “NPV Ushtrisë” sh.a., Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 5 251,4 (pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një presje katër) m², nga të cilat 2 071,4 (dy mijë e shtatëdhjetë e një presje katër) m², sipërfaqe funksionale, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për nevojat e Universitetit të Tiranës.

2. Universitetit të Tiranës, pas marrjes në përdorim të pronës së përcaktuar në këtë vendim, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Mbrojtjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.652, datë 14.9.2011

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER I
SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr.8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”/“Master i Arteve të Bukura”, për vitin akademik 2011-2012, të jenë 6676. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit
“Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura” | 6386; |
| b) Kuotat për programe të dyta studimi | 100; |
| c) Kuotat për transferimin e studimeve | 100; |
| ç) Kuotat për shtetasit e huaj | 50; |
| d) Kuotat për personat që nuk shikojnë | 20; |
| dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët | 20. |

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

- a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit

“Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për aplikantët brenda territorit të vendit,

6082;

b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për aplikantët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit

304.

3. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij vendimi shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë dhe përcaktohen në kolonën D të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë, sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave kryhet në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve dhe akteve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi, pasqyrohen në kolonën E, të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimeve për personat që nuk shikojnë ndahen për kandidatët me statusin e personave që nuk shikojnë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

6. Kuotat e pranimeve për romët dhe ballkano-egjiptianët ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga shoqatat përkatëse: Shoqata Kombëtare e Romëve dhe Shoqata Kombëtare e Ballkano-Egjiptianëve.

7. Kuotat e pranimit për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe ndërmjet vendeve.

8. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi dhe për transferim studimesh, të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë dhe numrin total të parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi.

9. Çdo program studimi i ciklit të dytë funksionon në vitin e parë për vitin akademik 2011-2012, në rast se atë e ndjekin të paktën 10 studentë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimit të kandidatëve dhe i bëjnë ato publike paraprakisht.

11. Tarifat e shkollimit për çdo kredit, për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, në vitin akademik 2011-2012, përcaktohen në kolonën F, të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

12. Tarifat e përgjithshme të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, në vitin akademik 2011-2012, përcaktohen në kolonën G, të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Tarifa e përgjithshme paguhet e njëjtë, si në rastet kur kohëzgjatja normale e programit të studimit është 2 (dy) vite akademike, ashtu edhe kur programi i studimit zgjat më shumë, në rastet kur ofrohet me kohë të pjesshme nga institucionet publike të arsimit të lartë. Pagesa e tarifës bëhet me këste të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së paracaktuar të programit të studimit, studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës, paguajnë vetëm tarifën për kredit të lëndëve të prapambetura.

13. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012 dhe që u përkasin shtresave sociale, si: personat që nuk shikojnë dhe që nuk dëgjojnë, invalidë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijët e policëve, dhe

ushtrakëve të rënë për shkak të detyrës e të ish-të përndjekurve politikë paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit. Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave sociale.

14. Në çdo program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, studentët e vitit të parë, që kanë përfunduar me Medalje të Artë ciklin e parë të studimeve dhe studentët e vitit të dytë që kanë përfunduar shkëlqyeshëm vitin e parë, nuk paguajnë tarifën e shkollimit për kredite, të llogaritura për të gjitha lëndët/provimet, pjesë e programit, në vitin akademik 2011-2012.

15. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, në kuadër të marrëveshjeve ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.

16. Transferimet e studimeve, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhet nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kritereve të përcaktuara në aktet nënligjore, statutet dhe rregulloret e tyre.

17. Studentët, që përfitojnë nga kuotat e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, u nënshtrohen tarifës së shkollimit të programit përkatës të studimit që ata kanë kërkuar.

18. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të porealizuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1: KUOTAT DHE TARIFAT E CIKLIT II, MASTER I SHKENCAVE/MASTER I ARTEVE TË BUKURA 2011-2012

A	B	C	D	E	F	G
K_UNIVERSITETI	K_ID PRO GRAM	K_EMERTIMI_PROGRAM	KUOTA PROG. studente Shqiptare	KUOTA nga TROJE T	Tarifa per Kredit (ne leke)	Tarifa Totale 120 Kredite (ne leke)
Universiteti i Tiranës	1	Gjuhësi	125	6	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	2	Letërsi	125	6	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	3	Histori	40	2	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	4	Gjeografi	62	3	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	5	Arkeologji	20	1	1,500	180,000
Universiteti i Tiranës	6	Trashëgimi Kulturore	20	1	1,500	180,000
Universiteti i Tiranës	7	Marrëdhënie Ndërkombetare	35	2	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	8	Gazetari	100	5	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	9	Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik	110	6	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	10	Përkthim Teknik-Letërar dhe Interpretim	80	4	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	11	Mësuesi në Gjuhë Angleze	120	6	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	12	Mësuesi në Gjuhë Italiane	60	3	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	13	Mësuesi në Gjuhë Frënge	40	2	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	14	Mësuesi në Gjuhë Gjermane	40	2	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	15	Biologji Mjedisore	10	1	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	16	Biologji Molekulare	15	1	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	17	Fizikë	15	1	850	102,000
Universiteti i Tiranës	18	Bioteknologji Molekulare dhe Industriale	40	2	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	19	Kimia Industriale dhe Mjedisore	40	2	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	20	Inxhinieri e Proceseve Kimike	40	2	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	21	Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore	40	2	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	22	Kimi	24	1	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	23	Inxhinieri Matematike dhe Informatikë	20	1	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	24	Informatikë	50	3	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	25	Matematikë	20	1	850	102,000
Universiteti i Tiranës	26	Mësues AM në Kimi	40	2	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	27	Mësues AM në Biologji	80	4	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	28	Mësues AM në Fizikë	40	2	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	29	Mësues AM në Matematikë	60	3	1,150	138,000
Universiteti i Tiranës	30	Përkatësi Gjimore dhe Zhvillim	60	3	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	31	Psikologji Shkollore dhe Organizacionale	80	4	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	32	Psikologji Klinike e Zhvillimit dhe Marrëdhënieve	40	2	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	33	Filozofi Sociale	80	4	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	34	Teori Politike	60	3	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	35	Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore	40	2	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	36	Punë Sociale	80	4	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	37	Mësues në Shkenca Sociale	50	3	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	38	Menaxhim Infermieror	150	8	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	39	Teknikë Laboratori	40	2	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	40	Fizioterapi	30	2	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	41	Mami	40	2	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	42	Imazheri	30	2	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	43	Shëndet Publik	20	1	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	44	Drejtësi Civile	100	5	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	45	Drejtësi Penale	100	5	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	46	Drejtësi Publike	100	5	1,000	120,000
Universiteti i Tiranës	47	Financë	85	4	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	48	Kontabilitet Auditim	40	2	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	49	Menaxhim Turizëm	20	1	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	50	Marketing	20	1	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	51	Sisteme Informacioni në Ekonomi	20	1	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	52	Ekonomiks	50	3	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	53	Administrim Publik	20	1	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	54	Administrim Biznesi	40	2	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	55	Kërkime Operacionale ne Menaxhim	20	1	1,400	168,000
Universiteti i Tiranës	56	Legjisllacioni dhe Institucionet e BE	30	2	1,250	150,000

Universiteti i Tiranës	57	Politika dhe Qeverisja në Evropë	30	2	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	58	Diplomacia dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare	30	2	1,250	150,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	59	Filozofi Sociale	40	2	950	102,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	60	Turizëm dhe Mikpritje	50	3	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	61	Aktuaristikë	30	2	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	62	Financë	70	4	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	63	Ekonomiks	50	3	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	64	Administrim Biznesi	70	4	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	65	Mësimdhënie e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë	70	4	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	66	Fizikë	50	3	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	67	Inxhinieri Navale	30	2	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	68	Marrëdhënie Ndërkombëtare	100	5	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	69	Matematikë	30	2	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	70	Matematikë-Financë	30	2	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	71	Pasuri e Paluajtshme	70	4	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	72	Pedagogji e Specializuar Sociale	25	1	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	73	Shkenca Infermiere	30	2	950	102,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	74	Shkenca Kompjuterike	40	2	950	102,000
Univ. Politeknik i Tiranës	75	Automatizim Industri	20	1	1,250	150,000
Univ. Politeknik i Tiranës	76	Energjitikë	15	1	1,250	150,000
Univ. Politeknik i Tiranës	77	Inxhinieri e Materialeve	10	1	1,100	96,000
Univ. Politeknik i Tiranës	78	Inxhinieri Mekanike	10	1	1,100	96,000
Univ. Politeknik i Tiranës	79	Inxhinieri Tekstile dhe Mode	10	1	1,100	96,000
Univ. Politeknik i Tiranës	80	Inxhinieri Fizike	20	1	1,100	96,000
Univ. Politeknik i Tiranës	81	Inxhinieri Matematike	20	1	1,100	96,000
Univ. Politeknik i Tiranës	82	Inxhinieri Gjeologjike	15	1	1,100	96,000
Univ. Politeknik i Tiranës	83	Inxhinieri e Burimeve Natyrore	0	0	1,100	96,000
Univ. Politeknik i Tiranës	84	Inxhinieri Gjeofizike	15	1	1,100	96,000
Univ. Politeknik i Tiranës	85	Inxhinieri Gjeomjedis	15	1	1,100	96,000
Univ. Politeknik i Tiranës	86	Inxhinieri Ndërtimi	60	3	1,400	150,000
Univ. Politeknik i Tiranës	87	Inxhinieri Mjedis	24	1	1,400	150,000
Univ. Politeknik i Tiranës	88	Inxhinieri Gjeodezi	25	1	1,400	150,000
Univ. Politeknik i Tiranës	89	Inxhinieri Hidroteknike	20	1	1,400	150,000
Univ. Politeknik i Tiranës	90	Inxhinieri Informatike	30	2	1,400	150,000
Univ. Politeknik i Tiranës	91	Inxhinieri Telekomunikacioni	30	2	1,400	150,000
Univ. Politeknik i Tiranës	92	Inxhinieri Elektronike	30	2	1,400	150,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	93	Politikë Agrare	20	1	1,000	120,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	94	Financiar	45	2	1,000	120,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	95	Ndërmarrjeve	30	2	1,000	120,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	96	Inxhinieri Agrare: Hortikulturë	20	1	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	97	Inxhinieri Agrare: Mbrojtje Bimësh	20	1	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	98	Inxhinieri Agrare: Prodhim Bimor	20	1	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	99	Inxhinieri Agrare: Agromjedis	40	2	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	100	Inxhinieri Agrare: Akuakulturë	20	1	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	101	Inxhinieri Agrare: Zooteknik	20	1	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	102	Agroushqimore	15	1	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	103	Inxhinieri Agroushqimore në Vreshtari-Enologji	15	1	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	104	Inxhinieri Përpunim Druri	20	1	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	105	Inxhinieri Pjore	30	2	1,200	96,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	106	Resurse Gjenetike të Bimëve	20	1	1,200	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	107	Administrim-Biznes	20	1	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	108	Biologji Mjedisore	30	2	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	109	Turizëm i Qendrueshem	30	2	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	110	E Drejtë Kushtetuese dhe Administrative	60	3	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	111	E Drejtë Private e Biznesit	60	3	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	112	Etnokulturë e Letërsisë Shqipe	30	2	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	113	Financë	20	1	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	114	Kontabilitet	20	1	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	115	Mësuesi në Biologji e Kimi: profil minor në "Karriera dhe Aftësimi për Jetën"	30	2	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	116	Mësuesi në Fizikë: profil minor në Informatike	30	2	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	117	Mësuesi në Gjuhë Shqipe: profil minor në Arte	30	2	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	118	Psikologji Organizative	20	1	950	114,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	119	Psikologji Klinike	20	1	950	114,001
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	120	Psikologji Ligjore	20	1	950	114,002
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodër	121	Studime Albanologjike	30	2	950	114,000

Univ. "L. Gurakuqi" Shkoder	122	Studime të Thelluara në Gjuhësi	30	2	950	114,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	123	Arkeologjike	40	2	850	102,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	124	Gjuhësi	40	2	850	102,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	125	Letërsi	40	2	850	102,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	126	Drejtim Bankar	30	2	1,000	120,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	127	Ekonomi dhe e Drejta në Tregjet Ndërkombëtare	30	2	1,000	120,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	128	Gjuhësi	25	1	1,000	120,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	129	Marketing	30	2	1,000	120,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	130	Matematikë e Zbatuar	25	1	850	102,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	131	Mbrojtje Mjedisi	30	2	1,000	120,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	132	Menaxhim	30	2	1,000	120,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	133	Psikologji Edukimi	30	2	1,000	120,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	134	Trashëgimi Kulturore	30	2	1,000	120,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	135	Administrim Biznes	70	4	1,000	120,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	136	Administrim Financiar	60	3	1,000	120,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	137	Administrim Publik	60	3	1,000	120,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	138	Bankë-Financë	70	4	1,000	120,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	139	Ekonomi-Biznes	40	2	1,000	120,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	140	Marketing	60	3	1,000	120,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	141	Arsimorë	60	3	1,000	120,000
Universiteti i Arteve Tiranë	142	Akrim	6	0	2,100	252,000
Universiteti i Arteve Tiranë	143	Koreografi	6	0	2,100	252,000
Universiteti i Arteve Tiranë	144	Muzikologji	4	0	2,100	252,000
Universiteti i Arteve Tiranë	145	Regji Filmi	6	0	2,500	300,000
Universiteti i Arteve Tiranë	146	Regji Teatri dhe Spektakli	6	0	2,100	252,000
Universiteti i Arteve Tiranë	147	Skenografi-Kostumografi	6	0	2,100	252,000
Universiteti i Arteve Tiranë	148	Piano	8	0	1,400	120,000
Universiteti i Arteve Tiranë	149	Violinë	8	0	1,400	120,120
Universiteti i Arteve Tiranë	150	Violë	2	0	1,400	120,240
Universiteti i Arteve Tiranë	151	Violonçel	4	0	1,400	120,360
Universiteti i Arteve Tiranë	152	Këngë Linke	2	0	1,400	120,480
Universiteti i Arteve Tiranë	153	Kontrabas	7	0	1,400	120,600
Universiteti i Arteve Tiranë	154	Flaut	7	0	1,400	120,720
Universiteti i Arteve Tiranë	155	Klarinetë	3	0	1,400	120,840
Universiteti i Arteve Tiranë	156	Oboe	1	0	1,400	120,960
Universiteti i Arteve Tiranë	157	Fagotë	6	0	1,400	121,080
Universiteti i Arteve Tiranë	158	Trombë	6	0	1,400	121,200
Universiteti i Arteve Tiranë	159	Korno	3	0	1,400	121,320
Universiteti i Arteve Tiranë	160	Trombone	3	0	1,400	121,440
Universiteti i Arteve Tiranë	161	Dirizhim	7	0	1,400	121,560
Universiteti i Arteve Tiranë	162	Kompozim	6	0	1,400	121,680
Universiteti i Arteve Tiranë	163	Pikturë Grafik	9	0	1,400	121,800
Universiteti i Arteve Tiranë	164	Pikturë Tekstili dhe Mode	9	0	1,400	121,920
Universiteti i Arteve Tiranë	165	Pikturë Multimedia	9	0	1,400	122,040
Universiteti i Arteve Tiranë	166	Pikturë Kavaleti	9	0	1,400	122,160
Universiteti i Arteve Tiranë	167	Pikturë Monumentale	9	0	1,400	122,280
Universiteti i Arteve Tiranë	168	Skulpturë	5	0	1,400	122,400
Universiteti i Arteve Tiranë	169	Skulpturë Qeramike	5	0	1,400	122,520
Universiteti Sporteve Tiranë	170	Shkenca Sportive	30	2	1,800	216,000
Qendra e Stud. Albanologjike	171	Shkenca Arkeologjike	15	1	1,750	210,000
Qendra e Stud. Albanologjike	172	Shkenca Etnologjike dhe Folklor	25	1	1,750	210,000
Qendra e Stud. Albanologjike	173	Shkenca Gjuhësore	20	1	1,750	210,000
Qendra e Stud. Albanologjike	174	Shkenca Historike	20	1	1,750	210,000
Qendra e Stud. Albanologjike	175	Shkenca Letrare	20	1	1,750	210,000
Akad. e Mbrojtjes "S. Moisiu"	176	Siguri dhe Mbrojtje	50	3	2,100	252,000
TOTALI			6127	306		

UDHËZIM
Nr.36, datë 9.9.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.25, DATË 20.7.2011 “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012”

Në mbështetje të nenit nr.102 të Kushtetutës, pika 5, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimin nr.423, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2011-2012”, të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimit në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, të vendim nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), si dhe të vendimit të Këshillit Ministrave nr.241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a, të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Germa “d” e pikës 7.2 të udhëzimit nr.25, datë 20.7.2011 “Për procedurat e pranimi dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012”, të ndryshojë si më poshtë:

“d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1. 550 lekë, paguar për llogari të universitetit, në çdo filial të Postës Shqiptare sh.a.”

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

VENDIM
Nr.81, datë 12.9.2011

PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “KALIVAC GREEN ENERGY” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (HEC I KALIVACIT), SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 9 pikat 1 dhe 2 germa “a” të rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Kalivac Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues të HEC “Kalivaçi”, si burim i rinovueshëm energjie, si dhe relacionin e Drejtorisë së Lincencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Kalivac Green Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e përcaktuara në rregullat e procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.9, datë 21.2.2007, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 , gërmat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, gërma “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 4, gërma “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit) si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 10.10.2011
Doli nga shtypi më 12.10.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 52 lekë